

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 170, Dhjetor 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



## Shoqata Atdhetare "Dukagjini" uron Krishtlindjen dhe Vitin e ri 2018



## 70-Vjetori i Ansamblit Folklorik Autokton "Rugova"

### REALIZIMET E VITIT 2017 - NJË BAZË MBËSHTETËSE E RËNDËSISHME PËR ECJEN NË VITIN 2018

Gjatë këtij viti janë realizuar këto veprimtari:

1-Gazeta "Dukagjini" ka dal rregullisht në çdo muaj, në saj të punës së anëtarëve të redaksisë, me në krye z. Luigj Shyti, e cila ka qenë e palodhur dhe të mundësorëve të saj, që kryesori është zoti Gjergj Leqejza, i cili ka mundësuar në botimin e shtatë numrave të gazetës; Ndue Ftoni, biznesmen në Miçigan të SHBA, i cili ka mundësuar në botimin e pesë numrave të saj; Anton Kosteri, Edmond Tërthorja dhe Mirash Ndrezaj, që kanë mundësuar botimin e nga një numri të gazetës. Gazeta e muajit dhjetor arrin numrin 170 të saj, një arritje mjaft e mirë...

### Dukagjinasit mblidhen përsëri për rrugën e Dukagjinit

Në bar-restorant "Tradita", me nisem e Gjon Dukgiles (3) i këtij biznesi dhe të shqiptaro (dukagjinasit) –amerikanit, N... (3) oni, me datën 14 dhjetor 2017, përsëri dukagjinasit mblidhen për rrugën e Dukagjinit: Prekal-Kir-Shosh-Breglumi-Theth e Qafe T' thore.

Në këtë takim ishin pjesëmarrës nga krahina e Shalës, Shoshit dhe Pultit, të cilët janë të interesuar për rindërtimin e kësaj rruge, se jo vetëm që rruga ekzistuese është jashtë përdorimit, por dhe kur ishte afërsisht normale, brenda një kohe të shkurtër...

# REALIZIMET E VITIT 2017 - NJË BAZË MBËSHTETËSE E RËNDËSISHME PËR ECJEN NË VITIN 2018

Të nderuar anëtar e anëtare të Shoqatës Atdhetare Dukagjini"! Të nderuar lexues të gazetës "Dukagjini"!

Viti 2017 u mbyll me shumë realizime.

Gjatë këtij viti janë realizuar këto veprimtari:

1-Gazeta "Dukagjini" ka dal rregullisht në çdo muaj, në saj të punës së anëtarëve të redaksisë, me në krye z. Luigj Shyti, e cila ka qenë e palodhur dhe të mundësorëve të saj, që kryesori është zoti Gjergj Leqejza, i cili ka mundësuar në botimin e shtatë numrave të gazetës; Ndue Ftoni, biznesmen në Miçigan të SHBA, i cili ka mundësuar në botimin e pesë numrave të saj; Anton Kosteri, Edmond Tërthorja dhe Mirash Ndreza, që kanë mundësuar botimin e nga një numri të gazetës. Gazeta e muajit dhjetor arrin numrin 170 të saj, një arritje mjaft e mirë.

2-Me datën 12 mars 2017, në mjediset e Bar – Restorant "Tradita", u zhvillua ceremonia e paraqitjes së librit, me titull "Lotaj e Shalës"-Monografi, me autor Zef Sokoli e Lulash Gilaj. Me këtë rast, disa figura të këtij fshati u nderuan nga Kryesia e Shoqatës, Zef Sokoli dhe Gjon Dukgilaj, me titullin "Anëtar Nderi i SHAD"; Armir Grima, me titullin "Nderi i SHAD", Kole Mark Kola, Mitër Kole Marku, dëshmorë Mirash Pal Vuksani, me titullin "Medaljoni Mehmet Shpendi"

3-Me datën 23 mars 2017, në orën 18.00, me një grup rreth 40 vetë, morëm pjesë në mjediset e Presidencës, në ceremoninë e dekorimit të zonës së Dukagjinit, me urdhrin lartë "Nderi i Kombit" dhe të Profesor Kole Preles (pas vdekjes), dekorimin e Poetit Frederik Rreshpja, me urdhrin "Mjeshtër i Madh", pas vdekjes, e organizuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani. Këto dekorime, u bënë me propozim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe të mbështetur nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Voltana Ademi. Në mes të pjesëmarrësve ishte Kryetarja e Këshillit të Qarkut, zonja Gerta Bardeli, N/Kryetari i Bashkisë, z. Arben Gjuraj, Piktori i Merituar Zef Shoshi, Prof. Dr. Vuksan Kola, Konsulli i Nderit të Republikës së Austrisë në Shkodër, dhe N/Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", zoti Gjergj Leqejza dhe të tjerë, veprimtar të Shoqatës sonë.

4-Me datën 29 mars 2017, me ftesë të grupit organizatore, në Rrëshen, një grup i përbërë nga Ndue Sanaj, anëtarja e kryesisë - Roza Pjetri dhe anëtarja e shoqatës, zj. Mirela Gjoni, mori pjesë në Simpoziumin "Historia e Mirditës në mes të katedraleve dhe kapedanëve", në të cilin mori pjesë dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani.

5-Me datën 22 prill 2017, një grup prej pesë vetë, mori pjesë në manifestimin "Zëri i Vëllazërisë - 2017", në Pejë, e organizuar nga Shoqata e Vëllazërisë

Kosovë-Malësi e Madhe, e pagëzuar "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë.

6-Me datën 1 maj 2017, në kuadrin e 15 vjetorit të Muzeut "Ivezaj", në fshatin Lekaj të komunës së Tuzit, me ftesë të Shtjefen e Gjyste Ivezaj, mori pjesë një grup prej 20 vete. Me këtë rast, Muzeu "Ivezaj" u nderua me titullin "Mirënjohja Martin Camaj".

7-Me datën 21 Maj 2017, ditën e diele, u organizua në Spaç të Mirditës ceremonia përkujtimore e Revoltës Antikomuniste të vitit 1973, e cila shpërtheu mes të dënuarve në Burgun e Spaçit. Në këtë ceremoni morëm pjesë me një grup nga anëtarët e shoqatës, Ndue Sanaj, Dede Toka, Fatmir Vojvoda, Roza Pjetri e Luigj Mila.

8- Me datën 27 maj 2017, në mjediset Bibliotekës "Marin Barleti", organizojmë ceremoninë e paraqitjes së dy librave historik, me titull: "Koshutani heroik i Rugovës Kreshnike" dhe "Rugova kreshnike dhe e kaluara e saj historike", të autor z. Fazli Muriqi nga Komuna e Rugovës. Me këtë rast, autori, z. Fazli Muriqi, u nderua me titullin "Mirënjohja Martin Camaj". Me këtë rast, u nderuan me titullin "Mirënjohja e SHAD", këngëtarët Pëllumb Vrinca, Gjovalin Shani, Gjovalin Perroni e Gëzim Zefi, për kontributin që dhanë në ceremoninë e dekorimit të zonës së Dukagjinit.

9-Me datën 5, 6 e 7 korrik 2017, ishim pjesë të veprimtarisë "Muza e Alpeve - 2017" e organizuar nga shoqata me të njëjtin emër, me qendër në Pejë. Ajo u organizua në Istog, në Shkodër dhe në Tuz.

10- Me datën 15 korrik 2017, organizohet ceremonia përkujtimore në vendin e quajtur Qeresh, në fshatin Gjuraj e Plan, me rastin e 102 vjetorit të Qëndresës së këtyre dy fshatrave, në kuadrin e qëndresës së gjithë Dukagjinit, kundër ushtrisë malazeze, në muajin korrik 1915. Në këtë ceremoni mori pjesë dhe N/Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Arben Gjuraj.

11- Me datën 9 korrik 2017, ditë e shtune, Ndue Sanaj e Luigj Shyti, me Edmond Tërthorja e Mikel Kopsaj, dolëm në Dukagjin, Shkodër – Prekal – Kir – Shosh – Kodër Shën Gjergj – Breglumi – Theth – qafë T'thore – Koplik – Shkodër, me shpenzimet e Edmondit e Mikelit. Me ne ishte dhe Aleksandër Shytani, mjeshtri i punimit të gurit. Në këtë përnjohje vendosëm të ngremë një memorial në Kodër - Shëngjergj dhe dy tabela, në të dy hyrjet në Dukagjin, njërën te Ura e Prekalit, në dalje të saj, në anën e futjes në qendër të fshatit Prekal dhe tjetrën në qafë të T'thores.

12- Me rastin e "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", me datën 23 e 24 shtator 2017, një grup i Shoqatës, vendosi pllakën përkujtimore në kishën e fshatit Theth, me mbi shkrimin: "Këtu, At' Shtjefen Gjeçovi, me 2 shkurt 1917, hapi shkollën shqipe"; në kishën e fshatit Plan, me mbishkrimin: "Këtu, At' Justin Rrota, me 1 dhjetor 1917, hapi shkollën shqipe" dhe në kishën (në Qelën) të fshatit Prekal, me mbishkrimin: "Këtu, At' Shtjefen Gjeçovi, me 17 shtator 1917, hapi shkollën shqipe". Në këto veprimtari, na shoqëruan administratorët e Njësisë Shale, Pult e Postribë dhe kryepleqtë e fshatrave Theth, Plan e Prekal, respektivisht Petrit Ara e Marash Rrgalla, Tom Ndoka e Pjetër Thani, Altin Shabaj e Marash Pjetri.

13-Me datën 9 tetor 2017, në bashkëpunim me Bibliotekën "Marin Barleti" dhe Shoqatën e "Shkrimtareve" të Shkodrës, organizuam promovimin e vëllimit me poezi – satire, me titull "Burrat vdiqën, të na rrojnë gratë" dhe libri, me titull "Zoja e Berishës", me autor poetin, publicistin e studiuesin Prele Milani.

14- Me datën 14 tetor 2017, për rreth katër orë, në sallën e konferencave të rektoratit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" zhvilloi punimet Konferenca shkencore, me temë: "100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin" organizuar nga kryesia e Shoqatës "Atdhetare Dukagjini". Merrnin pjesë shumë të ftuar nga bashkësia dukagjinase, personalitete të shkollës dhe kulturës të Bashkisë Shkodër, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Voltana Ademi; Nënkryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu; përfaqësuesja e Ministrisë së Kulturës, zonja Majlinda Laçaj; Drejtori i Drejtorisë së Arsimit të Qarkut Shkodër, z. Kadri Ymeraj; Rektori i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi, Prof. Dr. Adem Bekteshi; i dërguari i Monsinjor Angelo Massafra, Dr. Dom Nike Ukgjini. Ishin të pranishëm edhe të ftuar nga shoqata Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, zotërinjtë, Ukshin Jashari, Frashër Racaj, Ali Tahiri e Shpejtim Jashari; nga gjimnazi natyror profesional "Skënderbeu", në Kaçanik, drejtori i kësaj shkolle, z. Ibush Vishi, me shoqërues Nuhi Kuqi, Remzije Luta-Dardhishta e Fitore Bilalli; Kryetari i veprimtarisë letrare "Ora e Maleve" Rozhajë, z. Ali Daci; përfaqësuesi shoqatës "Mirëdita e Bashkuar", Gjon Bruçi; të shoqatës "Spani", z. Mhill Pali; të shoqatës artistike "Treva", kantautori Fran Kodra e të tjerë.

Në këtë veprimtari u dhanë 200 tituj nderi, medaljoni me mbishkrimin "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", figurave të arsimit e kulturës, që kanë punuar në Dukagjin dhe vijojnë të punojnë jo vetëm në mësimdhënie, por dhe nëpërmjet kulturës, hulumtimeve, studimeve e botimeve në shërbim të Dukagjinit e dukagjinaseve.

15- Me datën 28 tetor 2017, një grup mori pjesë në veprimtarinë e titulluar "Dita e Plisit" e organizuar nga veprimtari i saj, Ismet Krasniqi e Prend Buzhala, në Galice, në kullën e Azem e Shote Gal-

ica. Mori pjesë Ndue Sanaj, Prele Milani, Ndue Marshi e Anton Kosteri.

Me këtë rast nderuam me titull nderi: Çiftin luftëtar Azem e Shota Galica, me "Medaljoni Mehmet Shpendi", me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", aktorin, veprimtarin e poetin Ismet Krasniqi-Lala dhe piktorin e veprimtarin Idriz Berisha-Xhixha.

16- Me datën 2 – dhjetor 2017, një grup prej pese vete, Ndue Sanaj, Gjon Kosteri, Daniel Kopsaj, Lulash Brigja e Pëllumb Vatnikaj mori pjesë në festën e 70 vjetorit të themelimit të Ansambllit Folklorik Autokton "Rugova", ku jo vetëm përshëndetëm, por Ansambllin e nderuam me titullin "Mirënjohja Martin Camaj", valltarin më të vjetër dhe dekoruar me titullin "Mjeshtër i Madh", nga Presidenti Bujar Nishani, Kapllan Nikqi, i dhamë titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", dhe titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini" ju dha Kryetarit të Ansambllit-Vesel Nikqi, valltares Shpresa Lajqi e valltares Xhyke Zekaj,

\*\*\*

Në këto realizime është kontributi i të gjithë anëtarëve të kryesisë, të anëtarëve të shoqatës dhe i aktivistëve të saj.

Mirënjohje për punën e tyre!

\*\*\*

Këto veprimtari, që nuk janë pak, në veçanti konferenca shkencore, me temë: "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", nuk do të ishin realizuar pa kontributin, mbështetur financiarisht të personave si më poshtë:

Ministria e Kulturës.....	200 000 leke
Gjergj Leqejza.....	175 000 leke
Kole Çardaku.....	145 000 leke
E.Tërthorja e M.Kopsaj.....	139 000 leke
Ndue Ftoni.....	100 000 leke
Prek Gjonaj.....	100 000 leke
Anton Kosteri.....	37 300 leke
Prenda Shpendi.....	33 925 leke
Mirash Ndreza.....	25 000 lekë
Agim Gilaj.....	19 000 leke
Mhill Prroni.....	15 000 leke
Martin Martini (Bardhoja).....	10 000 leke
Zef Gjeta.....	10 000 leke
Pal Lera.....	10 000 leke
Dede Toka.....	5 000 leke
Roza Pjetri.....	4 000 leke
Agron Hasanaj.....	2 000 leke
Mirela Gjoni.....	500 leke
<b>Shuma.....</b>	<b>1 030 725 leke</b>

Këta mundësor i kemi uruar dhe i urojmë me gjithë shpirt, me shprehjen popullore, "Paçin e dhëncin!"

\*\*\*

Me gjithë punën e bërë, tërheqim vëmendjen në këto drejtime:

**Së pari**, degët e shoqatës nuk po funksionojnë si duhet, në veçanti dega e Malësisë së Madhe, dega e

# Dukagjinasi mblidhen përsëri për rrugën e Dukagjinit

Në bar-restorant "Tradita", me nisem e Gjon Dukgiles, pronari i këtij biznesi dhe të shqiptaro (dukagjinasi) –amerikanit, Ndue Ftoni, me datën 14 dhjetor 2017, përsëri dukagjinasi mblidhen për rrugën e Dukagjinit: Prekal-Kir-Shosh-Breglumi-Theth e Qafe T'thore.

Në këtë takim ishin pjesëmarrës nga krahina e Shalës, Shoshit dhe Pultit, të cilët janë të interesuar për rindërtimin e kësaj rruge, se jo vetëm që rruga ekzistuese është jashtë përdorimit, por dhe kur ishte afërsisht normale, brenda një kohe të shkurtër ka "hëngër" 54 jetë njerëzish, por mbi të gjitha rruga është jeta, pa rrugë nuk ka zhvillim.

Kjo rrugë, nuk është thjeshtë vetëm e dukagjinave, që banojnë në fshatrat e tij, e vetëm e dukagjinave që janë larguar prej tij, për një jete më të mirë, por dhe çdo shkodrani, shqiptari, por dhe çdo turisti, që kanë ardhur e po vijnë ta vizitojnë nga të gjitha anët e botës.

Takimin e hapë zoti Gjon Dukgila, i cili në mes të tjerave tha: "Ne jemi shumë të shqetësuar për gjendjen e kësaj rruge. Besojmë se pjesa e rrugës Qafe T'thore, në vitin e ardhshëm mund të përfundojë dhe mirë bëhet. Por, ajo nuk garanton gjithë vitin kalueshmëri. Kalueshmërinë gjithë vjetore e garanton vetëm rruga Prekal-Kir-Shosh-Breglumi-Theth, e cila është 74 km. Kjo rrugë, po të ndërtohet, mund të mirëmbahet më lehtë dhe gjithë vitin të jetë e kalueshme. Edhe herë tjera janë bërë përpjekje për sensibilizimin e shtetit për rindërtimin e kësaj rruge, por më duket, se zëri i dukagjinave nuk ka qene aq i fuqishëm dhe të jetë shkuar atje ku duhet, me përjashtim të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që i ka bërë disa letra Kryeministrit, zotit Edi Rama. Mendoj, se pa u bashkua dhe të bëhemi pjesë e këtij shqetësimi, vështirë të lëvizim kush aq shpejt sa ne dëshirojmë për rindërtimin e saj. Duhet secili dukagjinasi të bëhet pjesë e saj, duke dhënë dhe një kontribut sa do të vogël financiar dhe në veçanti biznes-

menët dukagjinasi. Besojmë, se së shpejti do të kemi një takim me Kryeministrin, zotin Edi Rama. Por, ne duhet të shkojmë para tij, me një ndjejnë dhe vullnet tjetër, që ai jo vetëm të njihet me shqetësimin tone, por dhe të kuptoi se e kemi marrë seriozisht rindërtimin e kësaj rruge duke u bërë pjesë e saj."

Pastaj foli zoti Ndue Ftoni, i cili solli para këtij tubimi shprehë shqetësimin e dukagjinave në SHBA dhe jo vetëm shqetësimin, por tha, se edhe ata do të bëhen pjesë e financimit të rindërtimit të saj. Ata, kanë ngarkuar Ndue Ftonin, që të

jo vetëm me peticione, por dhe deri me protesta para Kryeministrit."

Mori fjalën dhe zoti Ndue Sanaj, i cili foli në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që në mes të tjerave tha: "Shpesh lexojmë në rrjetet sociale, në mes njeri - tjetrit themi, se Dukagjini u braktis nga shteti! Shoqata e jonë këtë braktisje e sheh ndryshe. Dukagjinin të mos e braktisin dukagjinasi në radhe të pare. Pra, problemin ta shikojmë në radhe të parë te vetja, me një kërkesë të thjeshtë: "Mos pyet, se çfarë bën Dukagjini për mua, por pyet çdo ditë, se çfarë bëj unë

"Dukagjini". Pra, ne dukagjinasi të mos e braktisim Dukagjinin, se, në qofte se ne nuk e braktisim, ai do të jete dhe nga dora e njeriut "Perla shqiptare". Së dyti, të jemi më shumë besues ndaj njeri-tjetrit. Ne, dukagjinasi jemi njerëz të besës dhe për këtë mburremi, por ashtu siç mburremi para të tjerëve, të jemi më shumë besues ndaj njerit – tjetrit. Pra, secili të thotë fjalën e tij, se secili ka vendin e vet, por duhet dhe një here të zgjedhim grupin drejtues të këtij shqetësimi dhe ai të autorizohet të bëjë takimi me çdo strukturë brenda e jashtë vendit dhe të ndjeke rindërtimin e rrugës së Dukagjinit".

Pati dhe mendime të tjera, si nga Tome Ndoka, administratori i Njesisë së Pultit, Nikolin Guri, Agron Hasanaj, Agim Dardha e ndonjë tjetër. Roza Pjetri, shtroj mundësinë, që nëpërmjet ndonjë televizori të jepet ndonjë njoftim për tu bashkua te ndonjë restorant apo një objekt publik, që aty të firmoset një peticion me firma dhe numër personal sipas kartës së identitetit të secilit dhe të jepen kontribute financiare kundrejt një mandate arkëtimi. Mendoj, se do ketë frutë dhe do të bëj të mundur më shumë sensibilizimin



flasin e të kontribuojë në emër të tyre, në veçanti dukagjinin në Nju-Jork e në Miçigan. Gjithashtu, tha, se nuk duhet shqetësuar vetëm Kryeministri, por dhe strukturat e pushtetit vendor, zonja Voltana, kryetarja e Bashkisë, zonja Gerta, kryetarja e Qarkut, por dhe Prefekti, zoti Çesk Millja, përfaqësuesi i qeverisë, që këta të bashkëpunojmë më shumë me Qeverinë, se rruga e Dukagjinit nuk është partiake. Ne, nuk duhet të ndalemi e as të pushojmë për asnjë çast deri sa të arrijmë qëllimin,

për Dukagjinin". Për shumë gjera e them këtë, por një gjë më tërheq më shumë vëmendjen. Ndue Ftoni, ne Miçigan ka një biznes, të pagëzuar me emrin "FTONI DUKAGJINI MEET"; ndërsa në qytetin tonë, në Shkodrën tonë as dhe një kafe, me emrin "Dukagjini" nuk ka, përveçse Shoqata Atdhetare "Dukagjini" dhe gazeta e saj, po me emrin "Dukagjini" dhe që punojnë tash 15 vite vullnetarisht. Unë po të jem Kryeministër, këtë do kërkoja më së pari, më çoni te një biznes me emrin

edhe nëpërmjet faqes së internetit apo faqes së fb, që duhet hapur sa më parë.

Në fund u zgjodh grupi drejtues, për drejtimin e këtij shqetësimi popullor, të banorëve të Dukagjinit, i përberë: Gjon Dukgila, Petrit Ara (administrator i Njesisë se Shalës), Ndoc Ashta (administrator i Njesisë Shosh), Tome Ndoka (administrator i Njesisë Pult), Nikolin Guri, Agim Dardha, Ndue Ftoni dhe Agron Hasanaj.

Redaksia

Lezhës dhe ajo e Kurbinit! Pse? Nuk është e lehtë të përcaktohet arsyeja, por theksoj, se pa funksionimin e degëve, nuk mund të funksionojë Shoqata, nuk mund të realizohet misioni i saj. Kjo duhet të tërheqë shumë vëmendjen e anëtarëve dhe anëtarëve të shoqatës në bazë dege dhe në veçanti të jetë më e qarte për drejtuesit e degëve të Shoqatës.

**Së dyti**, anëtarët e anëtarët e shoqatës nuk po paguajnë kuotat dhe kryetarët e degëve nuk po i mbledhin ato. Duhet të jete e qartë për të gjithë, se anëtarët e anëtarët e shoqatës, që nuk paguajnë kuotat nuk mund të jenë anëtare e anëtar te saj.

**Së treti**, seksionet nuk po funksionojnë rregullisht. Me përjashtim të redaksisë, që funksionon vetëm Kryeredaktori, por jo redaksia, të tjerat seksione nuk funksionojnë si duhet. Pa funksionimin e tyre, nuk mund të funksionojë Kryesia dhe në tërësi shoqata.

\*\*\*

Duke u nisur nga këto arritje, por dhe në veçanti nga këto tre problematika të

punës së Shoqatës gjate këtij viti, duhet të tërhiqet vëmendja e anëtarëve dhe anëtarëve të Shoqatës, të drejtuesve të degëve dhe anëtarëve të kryesisë, se si duhet vepruar, që në vitin e ardhshëm, në vitin 2018, të mos na përsëriten..

\*\*\*

Të nderuar anëtarë e anëtar të Shoqatës, drejtues të degëve të Shoqatës, duke u bazuar në arritjet e këtij viti dhe në kërkesat e misionit të shoqatës, për vitin 2018, Kryesia e saj, me datën 11 dhjetor 2017, miratoj Planin e Veprimeve të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për vitin 2018, si me poshtë:

1. Vijimi i nxjerrjes të gazetës "Dukagjini" në çdo muaj;

2. Marrja pjesë në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë-2018", në muajin **prill 2018**, në Kosovë;

3. Festimi i 15 vjetorit të Themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", **me 13 maj 2018**;

4. Marrja pjesë në veprimtarinë "Dita Plisit" në komunën e Klinës, ose në Bashkinë e Shkodrës, në muajin **tetor 2018**;

5- Përgatitja e zhvillimi i zgjedhjeve në degë dhe ato të Përgjithshme të Shoqatës, në muajin **shtator – tetor 2018**.

6. Të bëhen përpjekje të organizohet një ekskursion, që me të rinj studente e student të Universitetit "Luigj Gurakuqi", të degës së historisë dhe gjeografisë, nëpër objektet historike të zonës së Dukagjinit, në muajin **qershor – korrik 2018**;

7. Mund të zhvillohen veprimtari përkujtimore e paraqitje libri, si pas rastit, **gjatë vitit**.

\*\*\*

Për realizimin e Planit të Veprimtarive të Shoqatës për vitin 2018, duhet dhe një burim financimi, i cili mund te jete:

1. Për botimin e gazetës "Dukagjini" **228 000 leke**;

2. Pjesëmarrja në Manifestimin "Zëri i Vëllazërisë-2018", afërsisht **120 000 leke**;

3. 15 vjetorit të Themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" **400 000 leke**;

4. Marrja pjesë në veprimtarinë "Dita Plisit" në komunën e Klinës, ose në Bashkinë e Shkodrës **300 000 leke**;

5. Përgatitja e zhvillimi i zgjedhjeve në

degë dhe ato të Përgjithshme të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" **55 000 leke**;

6. Ekskursion me të rinj, studente e student të Universitetit "Luigj Gurakuqi", kryesisht të degës së historisë dhe gjeografisë, në objektet historike të zonës së Dukagjinit **300 000 leke**.

7. Për veprimtari përkujtimore e paraqitje libri, afërsisht **85 000 leke**.

\*\*\*

Pra, afërsisht janë të domosdoshme për të organizuar, përgatitë e realizuar planin e veprimtarive të Shoqatës, për vitin 2018, rreth **1 488 000 leke**. Për sigurimin e tyre, ju bëjmë thirrje gjithë biznesmenëve dukagjinasi, emigranteve kudo janë, që nga të ardhurat e tyre, të bëjnë përpjekje të kursejnë diçka edhe për Shoqatën e tyre, Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", se me siguri në realizimet e saj, do të gjeni vetveten, punën e djersën e tuaj.

**Ndue Sanaj,**  
**Kryetari i Shoqatës Atdhetare**  
**"Dukagjini"**

# KUSH THA SE THETHI PO NDAHET NGA BABA!?

Lajmi që pash e dëgjova dje TV “Antena Nord” për fillimin e veprimit ligjor për shkëputjen e Thethit nga Shkodra, edhe tani që po shkruaj nuk më besohet, por edhe hedhja e një ideje të tillë qoftë edhe si sensacion mu duk naive dhe komike deri në donkishotizëm.

Kumtuesi i lajmit ka syzuar në shenjë kur thotë se, Bashkia Shkodër nuk e meriton Thethin: Jo vetëm Bashkia e Voltanës, por historikisht Shkodra nuk e ka merituar asnjëherë Thethin, Dukagjiniin as malet mburojë rreth saj.

Thethin nuk e ka merituar asnjëherë tash 105 vjet as shteti shqiptar. Paraardhësit e mi kanë luftuar thekshëm me pushkë kundër serbo-malazezëve. Dukagjini në këto luftëra ka humbur një vargmal fatosash bijë më të mirët të truallit të vet shkëmbor. Kreshtat, gurët dhe humnerat e Dukagjinit janë la me gjak dhe dinë me kallëzua të kaluarën. Qëndresa antisërbo-malazeze -jugosllave e Dukagjinit është një monument natyror kombëtar që nuk zhduket deri sa të mos zhduken shkëmbinj të Agrit-Boshit-Bigës e Gurit të Kuq.

Me trishtim dhe zemër të thyer po them atë që nuk ma mban goja, nuk ma ka soji as gjaku. Sikur Thethi dhe Dukagjiniin të kishin qenë pjesë e Malit të Zi, përveç aspektit të gjymtimit (nga trualli etnik) në aspektin ekonomik, rrjetin urbanistik, emigracionin normal, emancipimin social, madje edhe vetëpërfaqësimit politik do ishin dhjetëra herë më mirë.

E tmerrshme pra drama me një akt pambarim vijon tash një shekull shtypje,

diskriminim, varfëri dhe mungesë perspektive nga shteti amë ndaj një krahinë që ruajti si thëngjill nervin e pashibluar të shqiptarizmit në çdo kohë.

Thethi nuk është një kopësht laknash që mund t'i heqësh gardhin e t'ia bashkosh një bashtine të një komshiu tjetër.



Nuk kam asnjë iluzion se Shkodra e do apo e meriton ma shumë se Malësia e Madhe Thethin, përkundrazi alkimia Theth-Malësi e Madhe është shumë më e dukshme se Theth-Shkodër. Por Thethi para së gjithash është Dukagjini dhe për hir të një sentimentit apo naiviteti donkishotesk nuk mund të shkëputet nga Baba dhe të kalojë kapërcellin dhe të përfundojë rrepça (repa) në thar-

kun e dikujt tjetër.

Ku ishin këta vizionarë të mëdhenj, që sot kërkojnë referendum të shkëputen nga Shkodra, që heshtën si memecë kur u bë ndarja e re administrative e varrosi Dukagjiniin, ndërsa Thethi u hodh si zarë në dorën e starëve të pokerit politik. Ju tani

sapo u shpallët “Park Kombëtar Historik”, më vjen çudi që pa pritur ta shijoni mrekullinë e magjijshe dilni e shpallni bashkimin personal më Koplikun sikur të ishte Kopliku Luizana! Ju që fantazoni nisma a jeni shaljanë! A keni pyetur vëllanë e madh, se pse doni të ndaheni prej tij? A mendoni ju se mund të keni turizëm kulturor të shkëputur e të ndarë nga Dukagjini? A u shkon në mendje se sa pesho-

ni në konarin e historisë pa Dukagjiniin?! Asetet e Thethit shtohen dita ditës, ndërsa vetëm tani Kolombët e Tiranës e kuptuan se kanë zbuluar një “tokë të re”! Thethit kanë filluar t'i shprehin dashurinë të gjithë. E do Shkodra, por nuk është e zonja, nuk e meriton veç si derri bostanin. Thethin e do Tirana dhe po i thurë lajka, i shkelë syrin e i afron mrekullinë e rrezatuar me një rrugë gjysmake verore. E do edhe Malësia e Madhe si tata petullat me mjaltë pasi do ia shtonte kapacitetin dhe resurset turistike sa Shkodra do shkallmohej nga xhelozia.

Thethin e do kushdo që e sheh dhe shijon hiret e tij: Dashuria për Thethin është dashuri me interes.

Alpet ose me shqiptarë ose pa shqiptarë do të bëhen një ditë, prandaj çeshtja e Dukagjinit si një njesi turistike speciale mbetet një opsion i hapur, të cilën dukagjinasi duhet ta kërkonë me çdo mjet ligjor dhe demokratik. Tani për tani, në se rruga e Dukagjinit mbetet në këtë gjendje siç është dhe vetëm për Thethin do hapet “Tuneli i Lamanshit” mos u gëzoni se nuk do ta përballonin dot, pasi kapaku i tenxheres prej presionit do fluturojë e grosha do derdhet.

Thethit i uroj të behet një Zvicër e vogël, pasi Zoti i bëri se si vëlla e motër janë. Thethi në dritë e në terr, në vajë e në këngë, me tllina e pa tllina, me Shkodrën e pa Shkodrën, në jetë e në amshim është Dukagjini. Lokomotiva është Dukagjini, ndërsa Thethi vagoni më komod i pandashëm i tij.

Prele Milani

## NJË FALËNDERIM PËR EMIGRANTËT

Gjatë viteve të tranzicionit, i cili me sa duket po vijon gjatë, edhe shumë vite të tjera. Por kontributi i emigranteve është i pa diskutueshëm në prosperitetin dhe ecjen për para të vendit tonë. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm, se pa kontributin e tyre ngritja e mirëqenies të familjeve shqiptare nuk mund të ishte arritur. Prandaj edhe duhet tu themi FALEMINDERIT! Kontributi dhe dora e tyre është ndjere në të gjitha familjet, në qytet e në fshat, për të cilët, në vitet para të ardhurat e tyre kane qene më të mëdha. Por, gjithsesi ende dhe sot ata vijojnë të kontribuojnë, sidomos te mosha trete dhe shtresat në nevojë, për të cilat duhet thënë se kanë qene dhe janë shtresat më të vuajtura dhe mund të themi se janë lëne në harresë nga qeveritë, pavarësisht se i përkasin krahit djathtë apo të majtë.

Qëllimi i këtij shkrimi nuk është të merremi me qeveritë e qeverisjet, po me kontributet e sjelljet e emigrantëve ndaj prindërve e të afërmit e tyre në Shqipëri. Dashuria e patriotizmi tyre për vendin është skalitur në mendjen e shpirtin e tyre. Janë këta emigrant, të cilët u integruan në vendet Perëndimore. Krahas pareve të fituara, ata fituan kulturën, profesionet dhe edukatën e punës. Emigrantet hod-

hën poshtë barsoletën, se kur u takuan udhëheqësit jugosllav me ata shqiptar, se si Titua i thoshte Enverit. “Lëri të rinjtë të dalin në Perëndim se, ne kështu vepuam. Dolën si blete punëtore dhe sollën mjaltin në Jugosllavi. Enveri i tha” Ju mire po ne, rinin i kemi si grerëzat. Po ti lejojmë me dale në Perëndim, le që s' bëhet fjale për mjaltin që nuk sjellin, por na nxjerrin edhe sytë!”. Kjo frike e toli-taristëve ra poshtë, se emigrantet mbajnë me nder emrin shqiptar, dhe kontribuojnë në ngritjen e mirëqenies e të prosperitetit Shqiptar.

Është kuptim plote ajo që jetojmë për dite. Me qindra emigrant pasi kanë jetuar e punuar shumë vite në Perëndim, kanë hapur bizneset e tyre në vendin tone, krahëse kontributeve për vete e familjen. Ata kane punësuar me qindra punëtore. Ky kontribut ka ndikuar në rritjen e mirëqenies të familjeve të punësuarave edhe uljen e të pa punëve. Sipas të dhënave të fundit del se 1 120 000 shqiptarë të lindur në Shqipëri, jetojnë jashtë saj. Nga të dhënat del se rreth 128 milion euro, janë të ardhurat e emigranteve që hynë në Shqipëri. Këto të ardhura janë: 73 për qind vijnë nga Italia e Greqia dhe 27 për qind nga vendet e tjera perëndimore. Pra, kjo ka bërë që krahas ndërtimeve të shtëpive në vend banimet e tyre, ata kanë ndërtuar vila në bregdetin tonë, të cilat janë të stilit perëndimor. Emigrantet, të

cilët nuk kanë pasur mundësi të hapin biznese, por janë bërë specialist të shumë profesioneve, si ndërtues, mekanik, hidraulik, bojaxhi, hoteleri, turizëm, madje edhe bujq e blegtor. Këta punojnë vet, por ndihmojnë edhe të tjerët, që të mësojnë këto specialitete. Me qindra e mijëra emigrant kanë bërë bashkim familjar. Një pjesë madhe këtyre prindërve, pasi kane vite, kanë fituar pensione të plota e të pjesshme.

Krahas të mirave material që sjellin e të mbajnë në jetë normale prindit e tyre, e dinë se kur te dy prindit janë pensionist, sa të ardhura marrin. Pra, ndihmesa e tyre është primare për të moshuarit. Një pjesë fare e vogël e emigranteve bëjnë edhe atë që nuk duhet bërë. Madje një moshuar po thoshte, se vetëm një here në tre muaj më marrin në telefon. Edhe kur unë i marre në telefon, ata më thonë shumë shkurte, se po harxhoresh! Ne, mendja na rrinë te ata fëmijë, të cilët i kemi rrite me shumë sakrifica, duke lëne veten keq, me qellim që të ndjehen mirë ata. Po themi se edhe atyre ashtu do jua bëjnë fëmijët e tyre, kur të rriten. Këta janë shembje jo të radhe. Shembje pozitive ka me qindra e mijëra, për respektin që kanë për prindit e të afërmit e tyre.

Mendojë, se nuk është e tepërt të shkruajme për katër vëllezër, që punojnë e jetojnë në Perëndim, të cilët kanë shumë vite jashtë atdheut dhe asnjëherë nuk i

kanë harruar prindit. Madje edhe motrat e të afërmit e tyre. Këta janë: Pal, Nikolle, Leonardo e Sebastiano Gjok Vuksani, të cilët thonë: Ne nuk ndihemi mirë, kur nuk janë mire baba e nëna në Shqipëri. Nuk ka feste fetare, që nuk vinë një ose dy për ta festuar me prindit e tyre. Nikolla ka ardhur me 5 dhjetor për festen e Shënkolit vetëm për dy net, pa marre parasysh punën apo shpenzimet. Nikolla ka investuar edhe në të mirë të bashkësisë. Para disa kohësh, ka mundësuar financiarisht uniformat e ekipit të futbollit të rinjve të skuadres së futbollit “Besëlidhja”. Gjithashtu, është mundësor i rregullt i koncertit të “Trevesës së Dukagjinit”, për vitin e ri e të tjera.

Emigrantet për asnjë arsye nuk duhet të harrojnë prindit e të afërmit dhe në tërësi shoqërinë shqiptare, që theksin duhet ta venë tek shtresat në nevojë, jo vetëm materialisht, se shumë rendësi ka dhe ana shpirtërore, nëpër mes telefonatave, e formave të tjera.

Në këtë fund viti krahas falënderimit për të gjithë emigrantet, një urim i përzemërt është, urimi: Gëzuar festat e fund vitit, Krishëlindjen dhe vitin e Ri 2018, suksese e me faqe të bardhe në të gjitha aspektet e jetës.

Faleminderit! Faleminderit për kontributin tuaj!

Ndue ZIÇI

# Shugurohet meshtari Kolë Mitri nga fshati Lotaj-Shalë

Me datën 29.06.2017 në të kremten e Apostujve Shën Pjetri e Shën Pali në Kishën Katedrale të "Shën Shtjefnit" në Shkodër u shugurua Meshtar Frat Kolë Mitri që i përket Provincës Françeskane "Zoja Nunciatë" në Shqipëri e Mal të Zi. Meshën e orës 10.00 e udhëhoqi Shkëlqesia e tij Imzot Angelo Massafra OFM Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër – Pult ku me shtrirjen e duarve dhe lutjes së shugurimit e shuguroi Meshtar birin e Kishës dhe të Dukagjinit Fr. Kolë Mitri, së bashku me dy diakonët e tjerë që i përkasin klerit dioqezat të Arkidioqezës Shkodër – Pult, Dom Gaspër Kolaj dhe Dom Mark Pashkja.

Në këtë kremtim morën pjesë shumë meshtarë nga dioqeza të ndryshme që si gjithmonë janë të pranishëm në raste të tilla ditë gëzimi kur Kishës i shtohen bashkëvepruesit e saj për veprën e Ungjil-lëzimit. Po ashtu shumë besimtarë kanë marrë pjesë në këtë liturgji të shenjtë dhe ngjarje aq të gëzueshme. Besimtarët ishin nga qyteti i Shkodrës por edhe nga vendet që vijnë këta meshtarë të rinj, në rastin e Frat Kolë Mitri nga Shala-Dukagjini, ose



nga vendet ku ata kanë kryer shërbesat vitet e fundit. Gjatë Meshës Shkëlqesia e tij Imzot Angelo foli edhe për misionin që duhet të përmbushin meshtarët e rinj, sidomos theksoi që shërbesa duhet të jetë e kryer në bashkim me Ispeshkvin dioqezat dhe me eprorët e ligjshëm në rastin e Fr. Kolë Mitrit që është rregulltar, dhe në bashkim me meshtarët e tjerë e në dëgjues kundrejt eprorëve. Menjëherë sapo mbaroi kremtimi i Meshës meshtarët e rinj janë përshëndetur me popullin që u kanë bërë përgëzimet dhe u kanë bërë nderimin e hijshëm duke jua puthur duart e sapo shuguruara (sipas traditës kishtarë në rastin e shugurimit meshtararak).

Të dielën më datë 02 Korrik Fr. Kolë Mitri ka Kremtuar meshën në Kishën "Jezusi Dashuria e Mëshirshme" Boriç-Vrakë. Në Vrakë jetojnë prej disa viteve prindërit e Fr. Kolës. Mesha e parë e Fr. Kolës që filloi në orën 11.00 ishte e mbushur me momente të bukura hareje për ofrimin e flijimit të Meshës nga meshtari i ri. Famullitari i Boriçit, At Antonio Bozza në emër të vet, të motrave që veprojnë e jetojnë aty dhe të gjithë Famullisë, falënderoi

Zotin për këtë hir të veçantë. Përshëndetjeve dhe falënderimeve iu parapriu letra e At' Mario Bossio, i cili vite më parë, po në këtë kishë ka Pagëzuar Kolën. Në këtë Kremtim, Predikimin e mbajti Patër Fran Dushaj, Frati i Traboinit, ku me intuete te shenjtë i kujtoi se *je Meshtar pa harru kurrë të kënunit njeri*. Në përfundim të Eukaristisë Fr. Kolë Mitri falënderoi së pari Zotin që është burim i çdo hiri dhe thirrjeje, prindërit që e kanë rritur, fretërit me të cilët jeton, formuesit, dhe çdokënd tjetër që ka ndikuar në jetën dhe formimin e tij. Në fund të fjalimit të tij kujtoi me mall edhe vëllezërit e motrat e veta për mungesën e pranisë së tyre ngaqë jetojnë jashtë Shqipërisë, por nuk munguan edhe bashkëvendësit e tij nga Dukagjini që me krenari erdhën të gëzojnë në festën e birit të tyre. Fr. Kola shërben prej kohësh në Shenjtoren e Shna Ndout Laç-Kurbin, dhe këtij kremtimi i janë bashkuar edhe besimtarë nga ky vend. Mbas meshës në ambientet e Famullisë së Boriçit, të gjithë pjesëmarrësit mundën të festojnë së bashku.

Luigj Shyti

# Ta mbyllim dhe këtë vit me vallen e Pinguinit

Populli ynë, ka luftuar gjate historisë së tij, ka derdhur gjak për liri, pavarësi dhe dinjitet kombëtar. Shqiptarëve u ka ra për pjesë, të ndeshen me perandori e ushtritë më të egra të kohërave, që kanë kaluar nëpër Ballkan, me pushtuesit më të dhunshëm, më të armatosurit dhe më barbarët.

Nder këto beteja ne krijuam dinjitetin tone, lindem dhe rritem heronjtë, mitet, legjendat, modelet e qëndrestareve, para më të fortëve, më të mëdhenjve, e më të shumtëve. Kemi krijuar për këto personazhe dhe bëmat e tyre këngë, që i kemi interpretuar me plot frymëzim dhe pasion, valle plot ritëm e larmi, të veçanta nga koreografia e lëvizjeve dhe ngjyrat.

Lindem dhe rritem aq shumë heronj, morëm pjesë në aq shumë beteje, zbrazem aq shumë batave, ushqyem dhe rritëm aq shumë në gjirin tonë tradhtarë, patëm aq shumë konflikte brenda llojit tonë, sa na shkoi jeta ndaj dhe përziej, ço dhe ul, zbardh dhe nxi, prish dhe rregullo, hiq e ve, të vlerave të historisë të kësaj Shqipërie nga bijtë e saj.

E keqja e të gjitha të këqijave, menduam se e patëm nga sistemi totalitar, që na la të mbyllur, pa u njohur me botën dhe bota pa na njohur ne, pa ditur se çfarë mund të bëjmë, e çfarë nuk duhet të bëjmë, vetes dhe as shoqërisë.

E pasi e hoqëm qafet sistemin totalitar dhe morëm fryme lirisht, të flasim kur të duam dhe të bëjmë çfarë të duam, na u kujtuan fjalët e atij burrit Toka fort dhe qielli larte, jetët e keqja dhe qeveritë e forta, nuk na lanë me njohur ditë dhe me ec përpara.

Duke pëlqyer Amerike dhe Evropën, jo vetëm si miq e dashamirë të provuar, por dhe për pasuritë e tyre të mëdha, menduam se çfarë u tepron atyre, me na fal ne, na del dhe na tepron.

Duke besuar dhe ëndërruar për çekun e bardhe, pas viteve 90\_ të, në atë mënyrën tonë filluam të pastrojmë atë ekonomi të prapambetur, ato fabrika të ndryshkura, shkarravitim artin dhe kulturën tonë, e me qene se nuk kishim më armiq dhe nuk kishim nevojë për ushtri, hapem depot dhe u shpërndanë armët një e keqe që do të na ndjek për një kohe të gjate. S'ka plane, reforma, investime, projekte, nisma që marrin rrugë, që nuk pengohen pa u nisur, pa u përfunduar, pa u inauguruar.

Çdo model zhvillimi e përparimi, që aplikohet për tu praktikuar, në ekonomi, art, kulturë, në sektorin shtetëror apo privat, me shumë vështirësi arrihet diçka,

sepse ose vidhet, sabotohet, abuzohet, avullohet, korruptohet, transferohet, i del pronari, ose i ikën investitori, shpesh trafikant, mafioz, politikan, gjyqtar, prokuror e të tjerë.

E kësaj Shqipëria dikush mendon si ka humbur kokrra dhe nuk po e gjene, ose po e gjene me vështirësi, por ndoshta dikush do t'ia gjeje e do t'ia dorëzoje Shqipërisë tone. Ndoshta ne jemi lojtare jo profesioniste dhe kokrrën po e leme shpeshte te kapuçat zhelane, duke e ekspozuar, e duke mos përfunduar asnjë lojë, që kemi marr përsipër.

Për të ngushëlluar veten dhe duke shpresuar për të ardhmen, le ta mbyl-

lim këtë vit me vallen e bukur dhe interesante të Pinguinit. Kjo valle shpreh shpesh vrullin e zhvillimit dhe përparimit në shumë aspekte të shoqërisë tonë, këto vite të tranzicionit, dashurinë për njeri - tjetrin, hapësirën që leme për të mos penguar njeri - tjetrin.

Edhe pse Vitin e Ri e presim ashtu si askush si ne, me krisma, zhurma, tym e flake, do të ambientohet shpejt ndoshta me ne, duke na sjell më shumë shprese, mbarësi, shëndet, paqe, qetësi dhe integritet, siç ëndërron dhe e meriton ky popull.

Gëzuar e për shume vjet Krishtlindjet dhe Vitin e Ri!

Zef Bari



# 70-Vjetori i Ansambllit Folklorik Autokton "Rugova"

Ansambli Folklorik Autokton "Rugova", shënoi 70 - Vjetorin e punës, veprimtarive dhe të themelimit. Kjo perla e trashëgimisë kulturore shpirtërore, që lartësoi dhe nderoi jo vetëm Krahinën kreshnike të Rugovës, Pejën, Kosovën, por dhe gjithë kombin tone. "Margaritar" të trashëgimisë kulturore shpirtërore do të përkufizonim me të drejtë jetën dhe punën e Ansambllit Folklorik Autokton "Rugova", për sfidat, rrugëtimin dhe vështirësitë që përballoi këtu e shtatëdhjetë vjet, Për paraqitjet unike me folklorin burimor rugovas, për namën dhe vendin që i bëri vetes në fushën e kulturës anëkend trojeve etnike dhe më gjerë, për lartësimin dhe nderimin e Krahinës kreshnike të Rugovës. Ansambli Folklorik Autokton "Rugova" me paraqitjet e veta që burojnë nga thellësia e shpirtit dhe thellësia e shekujve, fitoi zemrat e miliona njerëzve.

## PAK HISTORI

Ansambli Folklorik Autokton "Rugova" u themelua, 70 vjet me pare, më 14 qershor 1947, nga Këshilli Popullor i Komunës së Rugovës, Drelaj. Drejtues të tij ishin ishte Ramë Kapllan Nikqi, jurist, kurse drejtuesi i tashëm është Vesel Nikqi, inxhinier. Gjenerata e parë kishte mbi 80 anëtarë, kurse sot ka po ashtu mbi 80 anëtarë aktivë, saktësisht 52 meshkuj dhe 32 femra. Programi i këtij ansambli përmban vlera autoktone të trashëgimisë kulturore të krahinës së Rugovës: doke, zakone, rite pune, rite dasme, rite lufte, këngë të kreshnikëve me lahutë, valle, kënga malësorçe, këngë epike historike, këngë me gisht në fyt, këngë lirike të vajzave dhe të nuseve, këngë dhe valle me tepsi, loja e dyluftimit me jatagan, loja e dyluftimit me pishqolla, loja e luftës me pushkë dhe lojëra të tjera popullore.

Ansambli Folklorik Autokton "Rugova" është paraqitur në Kosovë, në të gjitha festivalet dhe në manifestimet kulturore, në festivalet gjithëkombëtare, nga Drenasa e deri në Gjirokastër, në shume festivalet ndërkombëtare në Ballkan e Evropë. Ai është vlerësuar me vende të para nga juritë ndërkombëtare rreth dyzet herë. Ka marrë edhe 5 medalje të arta, 11 medalje

të argjenta dhe shume vlerësime nga shume organizata e shoqata nga mbare trevat shqiptare dhe ndërkombëtare.

Për këtë kontribut kaq të madh, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Bujar Nishani, me rastin e këtij përvjetorin, me datën 28 qershor 2017, Ansambllin Folklorik Autokton "Rugova" e dekoroi, me titullin e lartë 'Mjeshtër i Madh'. Gjithashtu, me këtë titull të lartë,

e Anglisë, ku zunë vendin e parë: gjeth, çifteli, lahutë e kavall.

Ansambli Folklorik Autokton "Rugova", në këtë 70-vjetor të themelimit, kujtohet se ka kaluar një rrugëtim historik shumë të suksesshëm. Kishte edhe vështirësi të mëdha. Në punën e ansambllit ka ndikuar edhe gjendja politike nën robërinë jugosllave, sidomos në periudhat e rënda që i përjetoi populli i Rugovës:

artistike edhe të shkallës së UNESCO-s, sidomos vijimësia e traditës së hershme ilire e riteve, e dokeve të lashta, e veshjes dhe e folklorit.

\*\*\*

Manifestimi u shënuar pikërisht në datëlindjen e Presidentit të Parë të Republikës së Kosovës, dr. Ibrahim Rugova. Shënimi i manifestimi filloi me 2



"Mjeshtër i Madh", dekoroi edhe Kapllan Nikqin. Kapllani, është anëtar i më i vjetër i ansambllit "Rugova", mjeshtër i kavallit, i fyellit, i gjethit, i myshnicës dhe i surles. Kapllani, për 65 vjet në ansambllin "Rugova", ishte i dalluar edhe në këndim dhe në vallëzim të valleve rugovase. Ai është po ashtu lahutar i dalluar dhe rapso. Me bashkëveprimtarët Bajram Ibishi dhe Hysen Asllani kënduan këngë malësorçe, këngë të kreshnikëve dhe ekzekutuan melodi baritore në 1966 në Langolen

dënimi i komandantit Zhukë Haxhia, vrasjet dhe burgosjet, mbledhja e tepriçave, aksioni i armëve, shpërngulja për Turqi, burgosjet politike, nga brezi i Sylë Mehmetit të NDSH-së e deri te brezi '68 i Republikës i Isa Demajt, brezi '81 i Ali Lajçit e brezi i luftës i Selman Lajçit në brigadën 136 "Rugova".

Ansambli i folklorit autokton "Rugova" është institucion me peshë të madhe etnokulturore për etnokulturën shqiptare dhe botërore, ku janë ruajtur vlera të larta

dhjetor 2017, në sallën e restorantit "Univers", në Pejë, në prani të një numri të konsideruar të të ftuarve dhe të artistëve të shumtë nga të gjitha trojet etnike, pikërisht në datëlindjen e ish presidentit dhe burrështetasit, shtetformuesit të Republikës së Kosovës.

Historiku i këtij ansambli i cili pasqyron jetën mes maleve, pa stinë, me natyrë të mrekullueshme, me borën e përjetshme në maja, që duket si një rojë besnike e qiellit, atje ku natyra bën ligjin, në datëlind-



jen e 70 prezantoi begatitë shpirtërore të trashëguara dhe të bartura nga brezi në brez.

Shumësi pjesëmarrjeje personalitetesh të shquara vendore dhe përfaqësues të të gjitha trojeve etnike, ishin në 70 – Vjetorin e tij. Ishte Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, kryetari i komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri, zv. Ministri dr. Ali Berisha, deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës, znj. Besa Gaxheri dhe z. Ali Lajçi, ish deputeti Florim Krasniqi, kryetari i KK Pejë dr. Islam Husaj, drejtoresha e Kulturës nga MK Vjollca Aliu e të tjerë.

Ishin të intelektualë të shquar rugovas të prirë nga prof. dr. Hasan Mujaj, shkrimtari Adem Shkreli dhe prof. dr. Ali Muriqi, po ashtu ishin prezentë edhe pjesëmarrësit e tryezës shkencore, e cila u organizua dhe u mbajt nën udhëheqjen e prof. dr. Zymer Nezirrit: AFA “Rugova” – thesar i trashëgimisë kulturore shqiptare, mbajtur të njëjtën ditë, po në të njëjtin vend, duke filluar në orën 10:00, prof. dr. Zeqirja Ballata, prof.dr. Zeqirja Nezirri, prof.dr. Adem Zejnullahu, prof.dr. Afërdita Onuzi, prof.dr. Bardhosh Gaçe, prof.dr. Hamit Xhaferi, prof.dr. Sabajdin Cena, prof. dr. Bukurije Mustafa, prof. dr. Albin Sadiku, prof. dr. Ismajl Doda, prof. dr. Rovena Vata, prof. dr. Bashkim Lajçi, pastaj studiuesit Shpresa Gjonbalaj, Fitim Çausi, Rini Useini, Melihate Zeqiri, Erodita Çorkadiu, Fitim Veliu, Ali Daci, Haxhi Lajçi e të tjerë.

\*\*\*

Përfaqësues të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me ftesë të Kryetarit të këtij Ansambli, zotit Vesel Nikqi, mori pjesë në festimin e këtij pervjetori, i përbërë nga Kryetari, Ndue Sanaj këngëtarët Gjon Kosteri, Daniel Kopsaj e Pllumb Vatnikaj dhe antari i redaksisë të gazetës, Lulash Brigja.

Në emër të Shoqatës, përshendeti, Ndue Sanaj, i cili Kryetarit të Grupit, z. Vesel Nikqi, i dorëzoi titullin “*Mirënjohja Martin Camaj*”, me motivacion: “*Për kontribut të vijueshëm në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare. Për bashkëpunimin e suksesshëm disaveçar midis nesh në veprimtari kulturore e artistike*”. Gjithashtu, anëtarit më të vjetër të këtij grupi, Kapllan Nikqi, ju dorëzua titulli “*Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini*”, me motivacion: “*Një jetë të tërë në shërbim të krijimtarisë, në përpunimin me përkushtim të këngës, valles autoktone nga treva e Rugovës*” Kryetarit te grupit te Ansambli Folklorik Autokton “Rugova”, zotit Vesel Nikqi, u dha titulli “*Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini*”, me motivacion: “*Për kontributin edhe bashkëpunimin si drejtues i Ansambli Folklorik Autokton “Rugova” në veprimtaritë e përbashkëta, si një artist model me vlera të spikatura artistike në shërbim të Kombit*”. Gjithashtu, ju dha titulli “*Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini*” edhe dy valltareve, zonjës Shpresa Lajqi e Xhyke Zekaj, me motivacion: “*Për kontribut si valltare dhe veprimtare me vlera të veçanta në veprimtaritë tona të përbashkëta; për pasqyrimin artistik të veshjeve kombëtare dhe imazhit epik të gruas Shq-*



iptare”

Zëri i moderatorëve Dodonë dhe Valdet Hysenaj shënoi fillimin e një dasme të madhe. Fillimisht një mirëseardhje për pjesëmarrje në dasmën e madhe përmes një përshëndetjeje, kronologji kohërash, erdhi nga kryetari i Ansambli z. Vesel Nikqi, pastaj një fjalë rasti e mbajti i zoti i shtëpisë, i pari i qytetit të Pejës, z. Gazmend Muhaxheri. Pas përshëndetjeve AFA “Rugova”, për kontributin shumëvjeçar dhe shumëdimensional, për përkrahjen dhe çmuarjen e vlerve kulturore kombëtare

Në fillim është paraqitur dirigjenti Memli Kelmendi me korin e qytetit të Pejës, pastaj recitatorja e vogël Almedina Demaj dhe natyrisht, AFA Rugova, të cilët me programin e tyre u shquan për shkallë të lartë interpretuese si dhe për mozaikun, kultivimin dhe ruajtjen e thesareve muzikore.

- Programi vazhdoi nga: Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe valleve “Shota”, ShKA nga Gostivari, ShKA nga Shkodra, ShKA “Malsori” Gjonaj - Has, Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Ilirida” nga Shkupi, Unioni Artistik i Kombit Shqiptar nga Tropoja, ShKA dhe “Shote Galica” nga Drenasi, ShKA “Dëshmorët e Kombit” nga Obiliqi, ShKA nga Skënderajt, ShKA nga Deçani,

Ato u shquan për nivelin e ekzekutimit të pjesëve të caktuara muzikore;

Në sallën “Univers” në Pejë, jehoi zëri i shumë rapsodëve dhe solistëve

Solistë dhe rapsodë si: Mustafë Ramaj, Arben Pozhari, Pëllumb Vatnikaj, Shaban Demaj, Daniel Kopsaj, Gjon Kosteri, Shemsedin Krasniqi, Bekë Nikqi, Shkelzen Kelmendi, e te tjere, në skenë sollën gjini dhe tipologji muzikore të cilësuar dhe vlerësuar si margaritarë të trashëgimisë shpirtërore shqiptare.

Filmat e shkurtër dokumentarë për lotën të pranishmit

U shfaqën edhe dy filma dokumentarë: Shtegtimi i Malsorit, në regji të Fatos Lajqit, i prezantuar gjatë tryezës shkencore dhe Kronologji 70- Vjeçare e AFA “Rugova” në përgatitje të Faton Bytyqit i shfaqur në pjesën e dytë të programit festiv, i cili njëkohësisht shfrytëzoi arkivin e pasur të kryetarit të Ansambli z. Vesel Nikqit, dokumentarë këta të cilët krijuan një pamje reale të jetës së rëndë të malsorëve në njërën anë si dhe shpalosën rrugëtimin e gjatë dhe të mundimshëm të kryeveprës së artit rugovas AFA “Rugova”, me të gjitha paraqitjet, sukseset dhe kujtimin për ata që na kanë lënë.

Nga ky ansambël u dha një falënderim i veçantë për Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, që dërgoj grupin e përfaqësuesve të Saj, në këtë festë.

Çastet, minutat dhe orët e përjetuara në këtë 70- Vjetor do të mbesin gjatë në mendjen dhe imazhin e secilit pjesëmarrës si kujtim i veçantë dhe i paharruar, për çdo pjesëmarrës në këtë festë, edhe për ne përfaqësuesit e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, për secilin anetar të Shoqatës dhe lexuesit e gazetës “Dukagjini” nëpërmjet të kësaj kronike, të festës së madhe të “70vjetori i datëlindjes së Ansambli Folklorik Autokton Rugova”.

*Ndue Sanaj e Lulash Brigja*

# 105 VJETORI I KRIJIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA SHQIPTARE

Shoqata "Aleanca Kombetare e Ushtrakeve të Shqipërisë", dega Shkoder, me datën 4 dhjetor 2017, në mjediset e Bar-Restorant "UNIONI", u mbledhën dhe përkujtuan 105 vjetorin e krijimit të Ushtrisë Shqiptare, e cila daton me 4 dhjetor 1912, pak ditë pas Shpalljes së Pavarësisë, me datën 28 nëntor 1912, si një domosdoshmëri përbërëse e strukturave të shtetit të Parë Shqiptar, por dhe për të qenë gati në mbrojtje të tij.

Mbas hapjes së këtij takimi nga Kolonel Viksan Vukaj, në pension, kryetari i kësaj dege, u dha himni i Flamurit Kombëtar. Gjithashtu u mbajt një minute heshtje për ndarjen nga jeta të kolegeve e kolegëve tonë. Pastaj ju dha fjala kolonel

Flamur Muça, në pension, për të mbajtur fjalën e rastit, mbi historinë 105 vjeçare të Ushtrisë Shqiptare.

Pas fjalës së Kolonel Flamurit, për disa nga anëtarët e kësaj dege u dhanë tituj nderi "Mirënjohja e Shoqatës AKUSH-Dega Shkodër", për kontributin e veçantë që kanë dhënë në funksionimin e degës së shoqatës, N/kolonel Skender Yzeiri, major Hajri Jenisha, major Dine Xheka, major Halit Ujkaj, dhe kapter Veli Bardhi.

Në mbyllje të kësaj ceremonie u kalua në një dreke të veçantë.

Redaksia



## HISTORIA 105 VJEÇARE E KRIJIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA SHQIPTARE

- 4 dhjetor 1912 - 4 dhjetor 2017 -



Kolonel Flamur Muça,  
në pension

E paraprirë nga ngjarja madhore si festa e Pavarësisë dhe festa e Çlirimit, 4 Dhjetori është bërë traditë, kur ushtarakët e më gjere festojnë datëlindjen e Forcave të tyre të Armatosura. Kjo datë përben për ushtarakët moment krenarie, nderimi e reflektimi. Në çdo vit të kësaj date lartësohen në kujtesën historike të Atdeut brezi i heronjve, të cilët në rrethana të vështira që ndezën luftërat ballkanike, me kuraja, me besim dhe me ide fisnike krijuan shtetin shqiptar, ku në përbërje të tij kishte Ministrinë e Mbrojtjes Kombëtare (Luftës). Ata burra patriot kryen një akt të papërsëritshmen dhe përjetësisht të respektueshëm. Madhështia e aktit të kryer ka zënë vend në kujtesën kombëtare.

Në periudhën e shkurtër të Qeverisë të Përkohshme të Vlorës të udhëhequr nga Ismail Qemali, Ushtria shqiptare, e re dhe e brishte, e udhëhequr dhe e drejtuar

nga gjeneral Mehmet Pasha Derralla, në detyrën e Ministrit të Luftës dhe major Shefqet Ali Shkupi, në detyrën e Kryetarit të Shtabit Madhor dhe oficerë të tjerë atdhetarë, të cilët deri në atë kohë kishin shërbyer në radhët e Ushtrisë së Perandorisë Osmane, bënë çka ishte e mundur. Kjo ushtri e përbërë kryesisht nga strukturat rezerviste, vullnetare, xhandarë dhe më pak forca aktive e kryen detyrën e vështirë, në kushte kur vijonte Lufta Ballkanike, për mbrojtjen e rendit e të pavarësisë së arritur me shumë përpjekje të shtetit të sapokrijuar.

Megjithëse koha e qeverisjes së tyre qe e shkurtër, përpjekjet e tyre qene të mëdha për organizimin e ngritjen e saj, si në krijimin e Shtabit Madhor, në muajin maj 1913, në nxjerrjen e akteve për milicinë, në organizimin në terren të veprimeve të forcave që kishin në dispozicion e të tjera. Por, kjo punë e filluar vrullshëm ndërpritet me dhënie të dorëheqjes të qeverise dhe ngjarjet që pasuan më vonë me ardhjen e princ Vidit e largimin e tij pas një kohe të shkurtër, fillimi i luftës të pare botërore dhe shkelja e territorit shqiptar nga ushtri të ndryshme penguan projektin e nisur nga qeveria e Vlorës.

Kongresi I Lushnjës i 20 janarit 1920 ishte historike për vendimet që mori për Shqipërisë e konsolidimin e saj. Qeveria e Sulejman Delvinës, që doli nga kongresi mori në dore fatet e vendit. Megjithëse, në fillimin e saj nuk përfshihej Ministria e Luftës, shpejt do të lindte nevoja e krijimit të saj dhe të ushtrisë shqiptare. Në mbledhjen e senatit, me 30 tetor 1920, kryeministri jepte pëlqimin për "formimin e një ministrie të luftës". Me krijimin e Ministrisë të luftës, me Ministër gjeneral Ali Riza Kolonja dhe Kryetar i Shtatmad-

horisë do të caktohej përsëri, Nënkolonel Ali Shefqeti. Ushtria shqiptare u organizua mbi bazën e tre regjimenteve ushtarake, që më vonë do të emërtoheshin Grup i Përzier. Me 5 dhjetor 1920 u emëruan komandantet e regjimenteve dhe u caktuan vendvendosja e tyre dhe e batalioneve në përbërje të tyre.

Në revolucionin e Qershorit të vitit 1924, forcat e ushtrisë mbështeten Fan Nolin.

Me ri-ardhjen në pushtet të Zogut, në vitin 1925, Shqipëria u shpall Republike, me President Ahmet Zogun, njëkohësisht dhe Komandant i Përgjithshëm të operacionit.

Me 1 shtator 1928, me miratimin e Statutit të ri, zë fill Monarkia Shqiptare, me Ahmet Zogun mbret. Në Statusin përcaktohej: Fuqitë e Armatosura të shtetit, nën urdhrat absolut të pushtetit përmbaues, kanë për detyrë mbrojtjen e Nderit, të Pavarësisë e tërësisë t' atdheut dhe t' interesave të larta morale e material të shtetit....Fuqitë e armatosura janë: ushtria kombëtare dhe xhandarmëria.

Me 25 shkurt 1929 parlamenti vendosi organizimin e rojës mbretërore e të kufirit si "si pjesë plotësuese e ushtrisë mbretërore", ndërsa në muajin nëntor 1929 u dekretua "ligji mbi organizimin e fuqive armate", ku sanksionohet emërtimi "Ushtri Kombëtare" dhe "Komanda e Mbrojtjes Kombëtare dhe behej ndarja e ushtrisë në tre lloj forcash, që ishin: Forcat Tokësore; Forcat Detare dhe Forcat Ajrore. Në vitin 1931 e në vijim kanë vepruar 6 Grupe të Përzier. Pjesa dërmuese e ushtrisë ishte këmbësori dhe artileri. Krahas krijimit të formacioneve ushtarake u hapen dhe shkollë për përgatitjen e kadrove aktive dhe ato rezerviste, për

përgatitjen e nënoficerëve sipas llojeve të armëve. Përgatitja e kualifikimi I oficerëve bëhej dhe në akademitë ushtarake, kryesisht në Itali e në ndonjë vend tjetër. Në ushtri vepronin dhe një numër I konsiderueshëm këshilltarësh ushtarake italian.

Prova e madhe e ushtrisë shqiptare ishte 7 prilli I vitit 1939, kur vendi i jonë u sulmua nga Italia fashiste nga deti dhe ajri. Ajo u gjend para befasive të mëdha, ku vet mbreti Zog nuk "veshi opingat", por me shpërën e tij mori rrugën e u largua jashtë vendit. Komandat ushtarake u treguan të mefshta para sabotimeve që ishin bërë me kohë nga këshilltarët dhe rezistenca qe e vakët. Ato nuk u mbështeten as te populli që kërkonte arme për ta prite pushtuesin. Shembulli i disa ushtarakëve aktive si Mujo Ulqinaku me shoke në Durrës tregojnë se forcat ushtarake që ishin me mijëra, po të ishin përdorur në operacionin e luftime mbrojtëse, fashistët do ta kishin pasur të vështire realizimin e objektivave të tyre. As në vijim nuk u organizua ndonjë lëvizje rezistence nga forcat qeveritare.

Me realizimin e pushtimit, në muajin maj 1939, u more vendimi për shkrirjen e "forcave ushtarake shqiptare" në "forcat ushtarake italiane", që u konkretizua në 6 batalione e bateri pasi u bë një "krehje" e personelit. Këto forca u përdoren dhe në luftën italo - greke, në vitin 1940, por shqiptaret nuk treguan vullnetin e duhur në luftime dhe u tërhoqën nga fushe betejja derisa u izoluan në Shijak.

Pushtimi fashist shoqërohet me lindjen e subjekteve politike, të cilat krijuan dhe forcat e tyre ushtarake. Krijimi i Frontit Nacionalçlirimtar në konferencën e Pezës i dha një hov lëvizjes të armatosur me krijimin e çetave e

# Periodiku i Shkodrës në vite

**Përgatiti**  
**Fatmira Lekiqi**

Me rastin e Festës së Pavarësisë, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Bibliotekën Publike "Marin Barleti" organizon ekspozimin e periodikëve të botuar në Shkodër ndër vite, të cilët ndodhen në Fondin Albano-Balkanologjik dhe Fondin e Periodikut.

Lindja e zhvillimi i shtypit shqiptar e atij shkodoran në veçanti u kushtëzua dhe kushtëzoi krijimin e kombit shqiptar dhe të shtetit shqiptar në periudhën e Rilindjes Kombëtare.

Edhe në Shkodër, qyteti më i madh i Shqipërisë me tradita të lashta historike e kulturore, me ekonomi, tregëti e borgjezi të zhvilluar për kohën, funksiononin grupe dhe shoqëri kulturore e politike për rigjallërimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqipe, organizoheshin takime, botoheshin libra dhe organe shtypi. Mes tyre bënë pjesë klerikë, intelektualë,

ideologë, mendimtarë, shkrimtarë, publicistë dhe përfaqësues të elitës politike otomane me origjinë shqiptare, të cilët morën përsipër organizimin kombëtar të shqiptarëve në luftë kundër pushtuesve osmanë, shovinistëve e Fuqive të Mëdha. Ndër to shquhet edhe At Gjergj Fishta.

Letërsi dhe politikë, kulturë dhe publicistikë, fe dhe atdhe - ishin përkushtimi i kësaj elite nismëtare të historisë së kombit shqiptar. Ky përkushtim vazhdoi edhe pas periudhës së Rilindjes Kombëtare me konsolidimin e shtetit shqiptar. E më pas vazhdon në varësi e në përputhje me zhvillimet historike.

Biblioteka jonë është e pasur edhe me koleksione të periodikut shqip nga koha e Lidhjes së Prizrenit e më pas, me vlerë të veçantë për kulturën tonë kombëtare. Nga 11 periodikët e botuar gjatë periudhës së Rilindjes në gjuhën shqipe, 7 prej tyre ndodhen në bibliotekën tonë. Dhe deri në vitin 1944 do të gjejmë edhe 50 periodikë të tjerë, një pjesë prej tyre me kohështrirje të gjatë të botimit në vite. Ndërsa pas vitit

1945 kemi numër të konsiderueshëm periodikësh, por jetëshkurtër. Pas viteve '90 e në vazhdim numri i periodikëve është mjaft i kufizuar e mjaft jetëshkurtër. Numri i përgjithshëm i periodikëve të botuar në Shkodër, që ndodhen në bibliotekën tonë deri tani arrin në 110. Kwtu janë ekspozuar rreth 80 periodikw nga kwtu 60 janë revista, fletore, kalendarw etj, ndwrsa 20 janë gazeta.

Mund të përmendim disa tituj periodikësh të rëndësishëm, si: "Ishkodra" (1979) organ i Degës së Lidhjes së Prizrenit në Shkodër; Elqija e Zembrës Jezu Krishtit (1891-...1913) e ndryshuar në Lajmëtarin e Zembrës Jezu Krishtit (1914-1944) organ i klerit katolik jezuit; vjetari "Shqyp-tari" (1904, shqip); organ i shoqërisë "Bashkimi"; "Koha" e "Bashkimi" (1910-1911), organ i shoqërisë "Bashkimi"; "Posta e Shqypnjes" (1916-1918) organ i Kuvendit Françeskan drejtuar nga At Gjergj Fishta; "Besa Shqipare" (1913-1921) drejtuar nga Ndoc Nikaj; "Zani i Shkodrës" (1915) drejtuar nga Ndoc Nikaj; "Ora e



batallioneve partizane në të katër anët e vendit. Për koordinimin e forcave Këshilli i Frontit mori vendim, që me 10 korrik 1943 të formohej Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me kryetar major Spiro Moisiu e komisar Enver Hoxha.

Edhe forcat politike si balli kombëtar e legaliteti formuan formacione ushtarake. Forcat e ushtrisë partizane në gusht 1943 filluan krijimin e formacioneve të mëdha partizane. Gjatë luftës Shtabi Përgjithshëm drejtoi 24 brigada sulmuese partizane, të kundruara në 8 Divizione dhe 3 Korparmata, me rreth 70 mijë forca duke mbajtur barrën kryesore. Mbas kapitullimit të Italisë fashiste, në muajin shtator 1943 dhe pushtimit të vendit nga nazistët gjermane, Shtabi i Përgjithshëm dhe forcat në terren përballuan dy operacione të mëdha të gjermaneve e bashkëpunëtoreve të tyre, si operacionin e dimrit 1943-1944 dhe atë të muajit qershorit të vitit 1944. Kongresi i Përmetit, i mbledhur me 24 maj 1944, mori vendime të rëndësishme dhe për ushtrinë, si për shndërrimin e saj në Ushtri të Rregullt, vendosi gradat ushtarake dhe bëri njësimin e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë, duke caktuar Enver Hoxhën.

Mbas thyerjes të operacionit fashist, Komandanti i Përgjithshëm urdhëroi kalimin e dy Divizioneve në Veri dhe fillimin e Mësymjes të Përgjithshme për çlirimin e plote të vendit. Beteja të përgjakshme u zhvilluan për çlirimin e qyteteve kryesore e sidomos të kryeqytetit, Tiranës dhe në fund të Shkodrës, që u realizua me 29 Nëntor 1994, datë që kremtohet si datë e çlirimit të Shqipërisë. Por kjo nuk shënoi fundin e luftës, sepse forcat e dy Divizioneve kaluan kufirin shtetëror në drejtim të Kosovës e Malit të Zi, ku bashkërendoi me forcat partizane kosovare e jugosllave për ndjekjen e armikut deri në Bosnjën Jugore. Nga lufta populli shqiptarë pati 28 mijë të vrarë, mijëra të plagosur; dëme serioze në pasurinë e tij.

Në këtë luftë populli i jonë u rreshtua në krah të Frontit Antifashist dhe ishte pjesë e Koalicionit të udhëhequr nga anglo-amerikanet e Bashkimi Sovjetik. Misionet ushtarake të tyre u atashuan pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, si dhe një mision e i tij u vendos pranë Shtabit Aleat në Bari të Italisë.

Çlirimi i vendit hapi një etape të re për Shqipërinë në tërësi dhe sigurinë e vendit në veçanti. Komandanti i Përgjithshëm menjëherë, me date 14 dhjetor 1944 u dërgon urdhër komandave e shtabeve të Korparmatave mbi disa ndryshime në organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, ku përcaktohen vendvendosja e tyre, zonat e veprimit, detyrat operative e të tjera.

Në përshtatje me situatat e brendshme e të jashtme, në këtë periudhë Ushtria e dale nga lufta do të quhet Kombëtare e me pas Popullore. Si vendi dhe ushtria do të bëhen pjesë e bllokut lindor komunist. Me krijimin e Traktatit të Varshavës, në vitin 1955, Shqipëria do të bëhet anëtare e tij de fakto deri 1961 dhe në vitin 1968 do ta denoncoj dhe me ligj do të shpalle daljen" de juro" nga Traktati i Varshavës.

Në varësi të këtyre zhvillimeve janë vendosur struktura organizative e ushtrisë, përhapja e njësive, detyrat taktiko-operative, planet për logjistiken, fortifikimin, krijimi e fuqizimin e industrisë ushtarake, e shume të tjera. Në zbatim të Artit ushtarak të Luftës Popullore janë përcaktuar planet e programet e përgatitjes të komandave e shtabeve, të trupës aktive e rezerviste për të gjitha llojet e armëve e shërbimeve, planet e pajisjes e kompletimit. Nga një ushtri kryesisht me këmbësori e pak artileri do të krijohet e futën armët bashkëkohore për këmbësorinë, artilerinë tokësore, bregdetare, kundërtanke, për artilerinë kundër ajrore e deri te sistemi rakete, do të zhvillohen mjetet e blinduara, flota detare do të pajiset me mjete lundruese mbi e nënu-

jëse, forcat ajrore me avionë mig 15-17-19-21 e të tjera.

Sistemi arsimor ushtarak do të pësojë një transformim. Shkollat ushtarake plotësonin të gjitha nevojat për të gjitha specialitetet dhe funksionet dhe zinxhirin e komandimit e të drejtimit, që deri në vitin 1960 një numër i konsiderueshëm studiuan në akademitë më me zë sovjetike.

Në varësi të nevojave për ndryshim, në vitin 1966 u vendos rivendosja e komisarit politik krahas komandantit, për krijimin e komiteteve e byrove të partisë në njësi, për heqjen e gradave ushtarake dhe ndryshimin e uniformes. U vendos sistemi i stërvitjes të Popullit Ushtar, në shkollat e lira ushtarake.

Planet e organizimit e kompletimit synonin mbrojtjen e vendit nga vija e kufirit në tokë, në dete e në ajër e deri në thellësinë e vendit, që realizohej me përhapjen e reparteve të gatshme e me kompletim për të kundërvepruar ndaj çdo kundërshtari apo grup kundërshtarësh.

Shtabi i Përgjigjem me organizimin e ri, në vitet 1982-83 drejtonte ushtrinë me rreth 16 500 oficerë, 9 000 nënoficerë, 60 000 ushtarë e 8 000 civile; me rreth 450 000 rezerviste e 23 000 forca vullnetare. Me 22 divizione dhe tre forca që ishin: Mbrojtja Kundërajrore; Flota Luftarake Detare dhe Aviacioni.

Shtabi i Përgjigjem kishte nën komandë 127 brigada këmbësorie, sulmuese, artilerie e tankesh. Këto forca dispononin rreth 1050 tanke, 4000 gryka zjarri artilerie tokësore, 34 regjimente të artilerisë kundërajrore pa llogarit artilerinë kundërajrore të brigadave. Aviacioni luftarak kishte 240 mjete fluturuese. Struktura ushtarake ishte që për 72 orë të mobilizonte nën arme rreth 750 000 ushtarake e qytetare në uniforme.

Rënia e sistemit monist dhe shndërrimet demokratik të viteve 1990, përfshinë dhe ushtrinë dhe përbërësit e tjerë të Forcave të Armatosura. Këto sfida gjendeshin në

konceptin e ri bashkëkohor për Forcat e Armatosura ashtu si edhe për reformimin e vizionit dhe misionit të tyre, dhe sigurisht për organizimin, përmasat numerike, simbolet, arsimin ushtarak, tekniken e armatimit, deri tek legjislacioni e rregulloret e tyre. Zbatimi i kësaj strategjie dhe i vizionit të ri, solli për rrjedhojë departizimin dhe zhvendosjen nga simbolet komuniste, shkurtimin e ndjeshëm të numrit të efektivit, të njësive ushtarake, të teknikës e armatimeve, dhe përqendrimin e forcave në garnizonet kryesore, si dhe rishikimin e doktrinës dhe strategjisë ushtarake për organizimin, veprimtarinë dhe përdorimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Në këtë rrjedhe, rendësi të posaçme mori orientimi për anëtarësimin në organizmat euroatlantik për tu përfshirë hap mbas hapi në sistemin e mbrojtjes kolektive evropiane. Kjo u bë realitet kur Shqipëria u pranua në NATO, me 1 prill 2009. Forcat tona të Armatosura sot krahas veprimtarisë në vend janë rreshtuar në përbërje të disa misioneve jashtë vendit si Irak, Afganistan, detin Egje e të tjera, në kuadrin e NATO-s, ku kanë bërë një paraqitje të lartë, duke e ngritur lart Flamurin Shqiptar. Për këto arritje ne kënaqemi e urojme forcimin e fuqizimin e mëtejshmen të Forcave tona të Armatosura.

Në këtë përvjetor, ne ndjehemi krenarë që jemi pjesë e këtij rrugëtimi të gjatë, ku për vite e dekada u arsimuam e kualifikuam, shërbyem me përkushtim pa u kursyer për t'i shërbyer Atdheut, me devotshmëri atje ku ai e kish nevojën, duke qene të gatshëm për të sakrifikuar dhe jetën për atdheun, detyrën e nderin. Në këtë ditë, një falënderim i veçantë shkon për familjet tona, që u bënë pjesë e sakrificave që kishte detyra jonë e na janë bërë mbështetje për të qene faqebardhe e kryelarte për çfarë kemi realizuar.

Gëzuar festën!

Rroftë Shqipëria!

# Shënime Epirotike

Autor: Antonio Baldaci

Në vitet 1913-1914, Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, u përpoq të sitemojë të gjitha çështjet që kishin prejardhje nga luftërat ballkanike. Duke iu shmangur çdo diskutimi retrospektiv në lidhje me zhvillimin e punimeve të asaj Konference, është edhe e kotë të diskutohen kompromiset që buruan në vijim të Luftës së Madhe për qëndrimin adriatik dhe për kushtetutën e Shtetit shqiptar.

Rezultati që, se Marrëveshja e Londrës lindi e vdekur dhe kufijtë e Shqipërisë u skicuan në një mënyrë kaq të shtrembër, saqë nuk i përgjigjeshin asnjë nevojë, sepse përshkonin sipas mendjes së tyre liqenet, pellgjet lumore, kreshta dhe kalime, sikurse ujdëtarëset të mos ekzistonin, kështu që, të drejtat e Shqipërisë së Plotë, të kërkuara nga patriotët shqiptarë dhe nga të drejtat e popujve, u shtypën në mënyrën më të bujshme dhe të turpshme, duke nxjerrë vetëm atë Shqipërinë e vogël aktuale, që rezultoi pa kuptim përballë realitetit.

Në çdo drejtim dhe në çdo kuptim duken sot mospërputhje të dënueshme, të kryera kryesisht nga Franca dhe nga Anglia në dëm të kombësisë së vogël shqiptare. Konstatimet që mund të bëhen për këto krime etnike janë të dukshme gjithkund, qoftë ndaj Jugosllavisë, qoftë ndaj Greqisë, ku masat shqiptare të shkëputura nga Mëmëdheu, bëhen, të mbledhura së bashku pothuajse sa trefishi i popullsisë së Mbretërisë së Shqipërisë.

Në jugun e Shqipërisë politike krahina e mbajtur prej Grekëve, që përbënte pjesën

më të madhe të "vilajetit" të vjetër turk të Janinës dhe që përfaqëson më shumë se dy të tretat e Epirit, popullohet nga një shumicë shqiptarësh, që nën sundimin e Gjysmëhënës vazhdonin të mbanin të gjallë e të fortë kombësinë e tyre. Edhe sot, megjithë shkombëtarëzimin me detyrim që e ka bërë propaganda greke, gjithë vendi përshkohet nga Kallamata (Tiamis) në Perëndim të Janinës drejt detit, është i zënë nga masa të konsiderueshme shqiptarësh që kanë treguar kundër çdo fytyrjeje të jashtme se t'i qëndrojnë besnikë rracës së tyre. Edhe në atë pjesë, kufiri i Shqipërisë aktuale, ndërsa nuk i qëndron çfarëdolloji prove as nga një këndvështrim gjeografik, as nga ai etnik, bie ndesh, sidoqoftë, edhe në aspektin administrativ, ekonomik, politik dhe ushtarak, në çdo kuptim, qoftë ndaj Jugosllavisë, qoftë ndaj Greqisë. Në Shqipërinë e Jugut, kufijtë e Kazasë së vjetër turke të Korçës, që do të duhej të përbënin kufirin shqiptar, u ndryshuan me detyrim: nga Grami deri tek gjiri i Ftelisë, kufiri prej kompromisi, i studiuar nga Komisioni i vitit 1913, u detyrua të lërë krejtësisht pasdore ndarjet administrative. Për të cituar një shembull, periferia e madhe e Konispolit, që sundon nga lart mbi kanalën e Korfuzit, është i ndarë nga deti, që menjëherë është më poshtë, nga një kufi jo i natyrshëm. Duke kujtuar Komisionin e viteve 1922-1926, për caktimin e kufijve shqiptarë, dhe duke i dhënë meritën se është përpjekur gjithmonë t'u lërë zonave të banuara afër një frymëmarrje të vazhdueshme për të nxjerrë ushqime dhe për t'u lejuar fshatarëve të paktën përdorimin e fushave të domosdoshme për mbajtjen e tyre, brenda shtetit ku bëjnë pjesë rezultatet e liga, që ngatërresat diplomatike i krijuan, bënë që në Shqipëri të caktohet një kufi i zi, si ai ekzistues mes Bullgarisë dhe Jugosllavisë, me fjalë të tjera, një kufi andej të cilit dhe këndej të cilit ishte e pa-

mundur që të mund të jetohej pa guerilje sapo ndonjë re më e dendur do të mund ta errësonte qiellin që kurrë nuk kishte paqe. Në lidhje me këtë, qeveria shqiptare, për të mbrojtur aspiratat e saj të drejta kombëtare (në traktatet e paqes, Franca dhe Anglia, caktuan që t'i njihet Shqipërisë vetëm një e treta e bazës së saj etnike), ishte përpjekur, qoftë edhe "pro forma", që ta mbajë të hapur udhën për të ardhmen. E kështu, megjithëse Dibra, Kosova dhe nënprefektura e Çamërisë gjendeshin jashtë Shtetit, u mbajtën idealisht me qëllime nacionaliste Prefekturat shqiptare të Dibrës dhe të Kosovës dhe Nënprefektura e Çamërisë. Natyrisht, kundër këtyre dimostrimeve, u ngritën me dhunë aspiratat jugosllave dhe greke, të cilat, në kompleksin e tyre, po të ishin realizuar, do ta kishin shtypur krejtësisht Shtetin shqiptar dhe do ta kishin katandisur në atë organizëm mikroskopik që qe propozuar në fillim nga Franca, nga Anglia dhe nga Rusia. Ai mezi do të kishte zënë rajonin e Durrësit dhe të Tiranës dhe kjo që të mbaheshin të gjalla dhe të plotësoheshin aspiratat e Greqisë që ishte çuar peshë deri më sot për një linjë që kalon përgjatë Vjosës deri përtej Këlcyrës, ku do të ishte drejtuar për tek liqenet e Ohrit dhe të Prespës. Kjo linjë ishte sidoqoftë kufizuese sipas propagandas panhelenike, e cila kishte për synim që të arrinte në të djathtën e Shkumbinit për t'u takuar në të djathtën e atij lumi me Jugosllavinë. Nga ai këndvështrim ushtarak është e dukshme se, kushtet e Shtetit shqiptar, lidhur me sigurinë e tij përballë pushtuesit, ishin shumë të vështira. Dalja nga Jugosllavia në Shkodër thjeshtësohej nga afërsia e menjëhershme e kufirit, kryesisht në Jug të liqenit. Vërshimi në zemër të Shqipërisë (kjo është vërtetuar edhe nga hyrja me dhunë e Zogut në prag të Krishtlindjes së vitit 1924, kur vërshoi me forcat jugosllave brenda Shqipërisë dhe ia

doli të shtie në dorë Shtetin) ishte bërë i lehtë përmes pellgjeve të Drinit të Bardhë dhe të Drinit të Zi, pjesët më malore të të cilëve gjendeshin në dorën jugosllave dhe janë larg nga Dibra në Tiranë për rreth 65 km linjë ajrore. Edhe dalja jugosllave në Korçë ishte e lehtësuar në afërsi të kufirit pranë Shën Naumit, nga rruga e përshtatshme për mjete me rrota Pogradec-Korçë. Në lidhje me Greqinë e, d.m.th., me Epirin verior (duke pasur ajo në duart e saj kreun e një dege të Devollit) kishte mundësi me shumë lehtësi të zbriste nga Florina gjatë rrugës që çon në Korçë. Nga Janina, pastaj, ishte e mundur të synohej duke ndjekur luginat e Vjosës dhe të Zrinit, në Berat, në Vlorë e në bregun e Sarandës në vetë Vlorën, siç u bë tashmë me antartët sapo qe formuar Shteti shqiptar. Ia vlen, ndër të tjera, të konstatohet se, në lidhje me Greqinë, meqenëse kufijtë e Shqipërisë arrinin në gjirin e Ftelis, ata copëtonin në ndonjë mënyrë njësine e zotërimit helen të kanalit të Korfuzit në hyrjen e tij veriore; rëndësia e kësaj rrethane ishte, në fakt, e madhe, meqenëse pengonte që ai kanal të mund të bëhej që nga koha e paqes një bazë e pashqetësuar ofensive kundër Italisë, por nëse qëndronte e dukshme siguria jonë, me ndarjen e kanalit të Korfuzit në greko-shqiptar, kjo siguri humbiste me bazën që Helenët dhe miqtë e tyre mund të stabilizonin në labirintin e Ishujve Jonianë dhe mbi bregun epiroik deri në hyrje të gjirit të Ambracias apo të Artës. Kjo është arsyeja kulminuese e politikës italiane, e cila kishte nevojë që Shqipëria të kishte edhe mushkëritë e saj detare me fuqi të plota, sa në veri, aq në jug, që të mos rrezikojë që të gjendet në mëshirën e armikut në atë të njëjtë det që me kaq xhelozë qe mbajtur dhe ruajtur nga Venecia.

**Përktheu: Nikolin Sh. Lëmezhi, Vëllazëria "Jeruzalemi i Ri"**

Maleve"(1923-1924) drejtuar nga Kolonel M. Gjoni; "Zani i Shkodrës"(1937) drejtuar nga Ndoc Çoba; "Fryma" drejtuar nga M.Pipa; "Kumbona e së Dielles" drejtuar nga D. M. Koliqi; "Zani i Atdheut"(1944) drejtuar nga M. Gjonmarkaj e botime të tjera të Shkodrës në vite.

Sipas një liste të botuar në numrin e parë të gazetës "Fjala e Shkodrës", të datës 24 qershor 1999, të botuar e drejtuar nga Irhan Jubica, në faqen Speciale,rezulton se në Shkodër që nga 1979 deri në 1999 janë botuar 112 periodikë. (Këto të dhëna janë marrë nga "Historia e shtypit shqiptar. I", me autor Hamit Boriçi e Mark Marku, Tiranë,UFOPress 2007.fq. 143.). Kjo listë nuk është e plotë, pasi në bibliotekën tonë gjejmë tituj të tjerë e kështu numri i listës arrin në 160 deri tani. Një numër të periodikëve të listës nuk i kemi në bibliotekë, po ashtu disa tituj të tjerë nuk i ka lista... Do të ishte me vlerë studimi i plotë e ribotimi i disa periodikëve më në zë...

E rëndësishme është të theksohet se në Shkodër kanë ekzistuar më shumë se 11 shtypshkronja deri në vitin 1944 të emëruara si më poshtë: Shtypshkronja "Zoja e Paperlyeme", Shtypshkronja "Nikaj", Shtypshkronja Franceskane, Shtypshkronja e Kollegjes Papnore, Shtypshkronja "Shkodra", Shtypshkro-



nja "At Gjergj Fishta", Shtypshkronja "Tirana", Shtypshkronja "Ora", Shtypshkronja "Ora Shkodrës", Shtypshkronja "Taraboshi", Shtypshkronja "Republika" etj.Në këto shtypshkronja janë shtypur mjaft libra, periodikë etj. Më pas deri

në'90-tën ekzistonin shtypshkronjat e shtëpitë botuese shtetërore. Pas viteve '90 numri i shtypshkronjave në Shkodër është i kufizuar.

Është interesant fakti se, që në fillimet e gazetarisë edhe në Shkodër janë lëvruar lloje të ndryshëm periodikësh, që njiheshin në botë, si; gazeta, revista, fletore, kalendarë, broshura, almanakë etj. Më pas kjo shumëllojshmëri zbehet herë pas here. E në ditët tona përsëri kemi vetëm gazeta, revista e ndonjë tjetër?!

"Format e pasqyrimin publicistik, në periudhën 1879-1944, janë ata të llojit informative dhe analitik: kronika, lajmi, korrespondenca, shkrimet letraro-publicistike si shënimi, reportazhi në formën e shënimeve të udhëtimit, skica e vizatimi dhe përshkrimi në formën e "rrëfenjës". Shtypi pati karakter kombëtar, popullor, iluminist, romantik, me përshkallëzim e jo rrallë alternim tematik e problemor në përshtatje me programet e mediave të veçanta apo grupimeve të tyre, si propaganduese e përhapëse e diturisë, të kulturës, të arsimit e të emancipimit qytetar, por edhe si mjet politik në luftën për çlirim kombëtar, si dhe paralelizëm linguistik, dy e tregjuhësia (për arsye të përhapjes e në varësi të shkollimit të autorëve)". (Marrë nga "Historia e shtypit shqiptar. I", me autor Hamit Boriçi e Mark Marku,

Tiranë,UFOPress, 2007.) Në vazhdim kemi llojin informativ, politik, fetar, kulturor, letrar, gjuhësor, pedagogjik, satirik e sportiv. Pas vitit 1944 kemi forma të pasqyrimin publicistik të përshtatura kërkesave të kohës, kur Shqipëria ishte Republikë Popullore Socialiste, me karakter informativ, politik, studimor, kulturor, letrar. Pas viteve '90, në vitet e demokracisë,kemi shkrime kryesisht informative, politike, fetare, kulturore, letrare, gjuhësore, argëtuese e sportive. Shkruhen vetëm në shqip të gjithë periodikët deri në '90-tën e më pas rikthehen një numër i kufizuar shkrimesh në dy e tregjuhësi, por tani thjesht për arsye të përhapjes së tyre. Funksionojnë edhe sot grupe dhe shoqëri kulturore e politike për rigjallërimin në veçanti të gegnishtes dhe të kulturës shqipe, organizohen takime, botohen libra dhe shkrime në shtypin e kohës. Mes drejtuesve të periodikëve të pas '90-tës bëjnë pjesë intelektualë, klerikë, ideologë, mendimtarë, shkrimtarë, publicistë etj.Vazhdimësia e botimeve periodike në Shkodër, në ditët tona, lë shumë për të dëshiruar.

\*\*\*

Kjo veprimtari e paraqites "Periodiku i Shkodrës në vite" u bë në mjedisin e bibliotekës "Marin Barleti" nën drejtimin e Drejtorit të saj, zotit Gjovain Cuni, me datën 23 nëntor 2017.

# Kryekomandant i çetave çlirimtare

Azem Galica u lind më 10 dhjetor 1889. I rritur në një familje me tradita luftarake e atdhetarie, që në fëmijëri u përcaktua në rrugën e lavdisë. I ati, Bejtë Galica, ishte ndër luftëtarët më të njohur të Drenicës, i cili ra heroikisht në betejën e njohur kundër satrapit Shemsi Pasha, më 1907, në mes Rezallës dhe Deviçit.

Bejta kishte edhe tre djem të tjerë: Seferin, Zenelin dhe Ademin, por Azemi ishte më i dalluari. Ishte i zgjuar, besnik dhe shumë i shkathët. Ende pa i mbushur njëmbëdhjetë vjet, me pushkën e dajës së vet, Kurt Selacit, në Selac, vret kriminelin serb, Stojanin.

Gjatë viteve 1910-12 shpërthyen kryengritjet e përgjithshme për pavarësinë e tokave shqiptare. Më 5 maj 1912 Hasan Prishtina doli në Drenicë, në kullën e Ahmet Delisë, mbathi opingat dhe dha kushtimin për një luftë mbarëkombëtare kundër Perandorisë osmane. Edhe trimi 20 vjeçar radhitet në çetat e Drenicës dhe merr pjesë në betejën legjendare të Merdarit.

Megjithatë, me theqafjen e Turqisë, mbi trojet tona të molitura u vërsulën bandat kriminale serbe. Luftëtarët e lirisë u ndoqën, u vranë dhe u burgosën. Edhe Azem Galica bashkë me dy vëllezërit arrestohet. Për disa muaj vuajti në baltën e Runikut, ku ishte formuar kampi famëkeq e rrëqethës. Drenicasit nuk duruan shumë. Një ditë e sulmuan dhe të burgosurit u liruan. Mirëpo xhandarët u vunë në ndjekjen e trimit, derisa e zunë dhe e dërguan në thellësi të Serbisë, në Zajeçar, gjegjësisht në Pozharevc. As prangat e rënda nuk e penguan shpirtin e etur për liri. Në pranverën e hershme të vitit 1915 Azem Galica u gjend në Drenicë.

Kthimi i tij ngjalli shpresat për ditë më të mira. Pa humbur kohë formoi çetën luftarake, e cila më vonë do të bëhet NËNA E ÇETAVE. Tashmë Azem Galica në Çetën e tij kreshnike kishte edhe shoqen e jetës e të pushkës, kishte Nusën e Maleve- SHOTË GALICËN, me të cilën zhvilluan gjashtëdhjetë e dy beteja fitimtare.

## ARBËRIA E VOGËL

Zona e lirë e Drenicës, që më shumë njihet si ARBËRIA E VOGËL, në fillim përfshinte të gjitha fshatrat e komunës së atëhershme të Prekazit e më vonë kufizohet në: Galicë, Lubovec dhe Mikushnicë. Kjo bërthamë e shtetit shqiptar, për ca vite rrezatoi atdhedashuri mbi të gjitha trojet shqiptare dhe frymëzoi luftërat për liri...

Dhe, dita e 15 korrikut e vitit 1924 gdhii fare ters. Forca të mëdha nga garnizoni i Shkupit, mbi 1200 veta, të përcjellë



edhe nga artileria e rëndë e përbërë nga shtatë topa e shumë mitraloza ia kishin mësyer Drenicës. Gjarpri i zi zvarritej drejt Arbërisë së Vogël, e popullata e Mitrovicës nuk merrte vesh gjë. As xhandarët vendës nuk kuptuan dot deri te Leskova, afër Lubovecit, kur koloneli Stojanović, në prani të Zhupanit të madh të Shkupit, lexoi urdhëresën se shkonin për ta rrethuar Azem Galicën. Sulmi duhej të ishte i bëftë dhe i furishëm...

Në atë betejë mori plagët vdektare edhe kryehroi Azem Galica, i cili ndërroi jetë dhjetë ditë më vonë, më 25 korrik 1924, në malet midis Përçevës dhe Gllarevës, duke lënë këtë porosi:

*-Vëllezër! Amanet atdheun, ruajeni dhe luftoni të bashkuar për lirinë e tij. Të palgosurit dhe fëmijët jetima i përcillni në Shqipëri. Ti Shotë, mos iu ndajë çetës. E di që kurrë s'ke me e korit emrin dhe trimërinë tënde. Lamtumirë vëllezër!*

*Kosova dhe ju më dhatë fuqi, zemër e krah lufte. Edhe i vdekur kam dëshirë me luftue bashkë me ju. Prandaj trupin më ma djeg ose më ma qit në një pus të pafund. Armiku nuk duhet ta marrë vesh vdekjen time. Trimat nuk kanë kohë të përlojnë. Shtrëngoni fort armët, lufta nuk duhet ndërpritur...*

Atë mëngjes të mugët të 25 korrikut 1924, nga gurmazi i thellë i shpellës "Çuku që kërcet" jehoi kushtimi: **O prite Azem Galicën prite, moreeeee!**

**Arbëria e Vogël, në atë betejë pati këtë bilanc të vvarësh e të plagosurish:**

### Të vvarë në Galicë:

1. Bahtir Beka, 2. Hasan Lahu, 3. Ismail Lahu, 4. Mursel Ferizi (fëmijë) 12-vjeçar, 5. Sylë Sahiti, 6. Selman Ademi, 7. Sadri Ahmeti, 8. Sinan Ahmeti, 9. Ferat Hyseni, 10. Sherif Rrahmani, 11. Mehmet Rrahmani, 12. Hamide Rrah-

mani, 13. Osman Mehmeti, 14. Hajdin Mehmeti, 15. Jashar Behrami, 16. Rustem Behrami, 17. Veli Halili, 18. Avdi Halili, 19. Shaban Tahiri, 20. Qerim Shabani, 21. Kamer Xhema, 22. Sylë Idrizi, 23. Hazir Fetahu, 24. Sinan Ujkani, 25. Nezir Beqiri, 26. Zahide Zeqiri, 27. Beqir Beqiri, 28. Hys Popova - Popovë, 29. Bajram Delia - Tërnavc, 30. Sinan Açaeva- mysafir, 31. Isa Shabani - nga Rashani.

32. Abaz Bajrami - rom, 33. Shak Bajrami - rom, 34. Ibrahim Bajrami - rom, 35. Man Bajrami - rom,

### Të plagosurit:

1. Rexhep Dauti, 2. Xhemail Lahu, 3. Ahmet Hajra, 4. Abdulla Zena, 5. Hamzë Zena, 6. Hashim Bahtiri, 7. Halit Sylë, 8. Rushit Sylë, 9. Rizah Velia (7 plumba), 10. Murat Velia, 11. Zymber Salihu, 12. Rustem Hamza - Hodiqi nga Klina, 13. Brahim Ferizi dhe 14. Hajrush Ahmeti.

### Të vvarë në Mikushnicë:

1. Ismail Manxholli, 2. Ahmet Manxholli, 3. Mehmet Manxholli, 4. Jashar Behrami, 5. Ali Behrami, 6. Hlil Behrami, 7. Sadik Behrami, 8. Bahtie Avdiu, 9. Hafie Avdiu (5 vjeçare), 10. Rexhep Hyseni, 11. Cenë Muharremi, 12. Sadik Salihu, 13. Ujkan Mehmeti, 14. Mehmet Alia, 15. Munish Ademi, 16. Bajram Sahiti (nip nga Baica), 17. Ajete Sadriu, 18. Hasime Musliu, 19. Bajram Barja, 20. Hajzer Barja, 21. Sadik Ramadani, 22. Sadri Zeneli, 23. Salih Fazliu,

### Të plagosurit:

1. Bajram Avdiu, 2. Milazim Sejdiu, 3. Shaqir Osmani, 4. Ukë Ramadani, 5. Hanife Avdiu, 6. Shesivar Ademi, 7. Ahmet Salihu dhe 8. Isref Avdiu.

### Të vvarë në Lubovicë:

1. Halim Bajrami, 2. Murat Bajrami, 3. Asllan Bajrami, 4. Bajrush Bajrami, 5. Salih Xhemaili, 6. Sadik Rama, 7. Qerim Shashi, 8. Zyhër Miftari, 9. Behram Delia, 10. Cekë Sejdia, 11. Xheladin Veliu, 12. Tafil Jetullahu, 13. Zenun Sherifi, 14. Maksut Islami, 15. Tahir Islami, 16. Islam Neziri, 17. Demë Beqiri, 18. Zeqë Beqiri, 19. Idriz Isufi, 20. Shaban Ademi, 21. Kurt Osmani, 22. Mustafë Abazi, 23. Selman Beqiri, 24. Bajram Koshtova (nip nga Koshtova).

### Të plagosurit:

1-Bahtir Osmani, 2. Istref Kadriu, 3. Emin Hasani dhe 4. Avdullah Kadriu.

*Përgatitur nga  
Milazim F. KADRIU*

poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi\*\*\* poezi \*\*\* poezi

**Nanë...**  
Fjalë e shenjtë ndër vite e mot  
Simbol i jetës forcë e shpirtit tim  
Një koleksion të rrallë mblodha sot  
Me netët e tua pa gjumë deri në agim.

Edhe në këtë moshë përsëri shërben  
Vitet të kanë randue në dorë mban një shkop  
Me na gostit kurdoherë të pëlqen  
Dhe me kundërshtue asht e kot.

Si ujët e lumit koha kalon  
Fytyra e jote... zemrën m'a ndezë  
Du me të ndihmue por s'mundem dot...  
Një forcë më ndalon... Nuk kam shpresë!

O Diell ndriçojë më shumë Tokën  
Rrezet tuaja ti dhuruan nanat!  
Ato ngrohtësi i japin Botës  
Dhe freski si ujët e burimeve tona.

**ÇERDHJA E TIJ U BA COPË- COPË**  
E prenë plepin, ra për tokë  
Çerdhja e tij u ba copë - copë  
Nanë e babë, vëllaznit e shkretë  
I dhanë vehtës hop përjetë....

Fluturuen në pemë të tjera  
Për sa ndodhi u hyni tmerra  
Më i vogli mbeti mbrapa  
Në një qoshe dikund përjashta.

Si t'ia baj tha me vedi?  
Kjo mënxyrë seç më gjeti!  
Fillikat mbeta i vetëm!  
Gjithëçka pata m'ka tretun!

Menjëherë u hap dera  
Bam-bum, më bani zemra!  
Shpejt u hodha te një tendë  
Mbas oborrit atje mbrendë.

Macja e shtëpisë hapi sytë  
U ba gati për me mbytë:  
Tha me vedi e lumja unë!  
Ky zog qënka si pëllumb!

Oh, sa mirë te kjo shtëpi!  
Për fat gjeta mjaft mirësi  
Djali i saj një çamarok  
Dromca buke më hodhi sot.

Ai më shikoj me dashni  
Kishte qejf me m'marr në gji  
U afrue me shpejtësi  
Kurse unë ika prej tij.

Kapërceva në një degë pranë  
E shikova si dikur vëllanë  
Edhe unë e due shumë!  
Sa i mirë qënka ky çun!

Këtu naltë mbi këtë derë  
Po e ndërtoj folenë  
Sigurisht për disa ditë  
Se mandej due me ikë.

Do të shkoj patjetër në pyll  
Ata atje kanë hyrë

Një mbas një kur ti takoj  
Me mall do i përqafoj.

Sa filloj u afrue nata  
Erdhi djali thirri nana:  
Qysh atëherë kur jemi nda  
Gjum në sy nuk kam ba...!

**MIRË SE VINI MISHTERI**  
Mirë se vini mishteri  
Në çdo kohë ju shërbej  
Mos harroni miqtë e mi  
Nesër keni hollidej.

Urdhëroni, zotni këpuca  
Qënka ba tan pluhun e baltë  
Prej saj asnjëherë s'u shkëputa  
Nga mëngjesi deri në darkë.

Mbas punës shkoj në shtëpi  
Jam rehat, s'bahem merak  
E ndejë vehten si djali i ri  
Nuk dorëzohem, jo, aspak!

S' njoh as edhe një deputet!  
As ministra qeveritar!  
Ndonjë me shaka më thotë "mbret"  
Këtu, te "Ruga e Durrësit", në kryeqytet.

**DUART E MIA JANË ME KALLO**  
Duart e mia janë me kallo  
Disa herë i vras në punë  
Më dëgjoni alo-alo  
Me djersë të ballit jetoj unë.

S'kam dyqan as kurrfarë çifligu  
Megjithatë nuk jetoj keq  
Sinqerisht, i juaji hidrauliku  
Çdo difekt do e ndreq.

Sa mizore qënka mosha!  
Mbi supe godet me "sqep"  
Më freskohet çdo herë koka  
Kur paratë i fus në xhep.

Më dëgjoni ju të rinj:  
Kur njeriu ka vullnet  
Ai udhëton në Gjithësi  
Dhe pushton çdo planet!

**FURRA IME ËSHTË MË E VJETRA**  
E kam zemrën prej floririt  
Më rinon çdo herë "mikesha"  
Ditë e natë afër zjarrit.  
Urdhëroni "tepsitë e pjekura".

Një jetë në profesion  
E fillova pa u rritë  
Ai më dha forcë e pasion  
Rrugën time e ka ndritë.

Baba ka qenë me famë  
Shumëkush e ka njoftë  
Një urim për ne ka lanë:  
Për të gjithë puna qoftë.

Kur të ndërroi jetë  
Më çoni pranë prindërvet

Të pushoj i qetë  
Atje te nana ime.

**BIE BORIA TRING ZILJA**  
Ijo, ijo, forca Bardhi  
Me hap madhështor kalo  
Çiftit të ri sahati i hajrit!  
Para krushqëve ndalo.

Kam familje tetë persona  
Gjashtë fëmijë për të rritë  
Mos harroni se karroca  
Është për mua ajr e dritë!

Bie boria, tring zilja  
Kanga e vallja s' pushon  
Si dy yje dhandri e nusja  
Si dita e re kur agon...!

**SHIKO MAMI, ERDHI BABI**  
Që nga larg duket makina  
Mos vallë është ai?  
Ajo zbrer nga malët tona  
Ata janë miqtë e tij!

Shiko mami, erdhi babi!  
Po bir,shpirti im!  
Ka një javë pa ardhë në shtëpi!  
Ditë e natë në udhëtim!

Afër Qiellit si shqiponjë  
Në mes të rrebeshëve kaloj  
Naftë, hekur, bakër e krom  
Shqipërisë i dhuroj.  
**Luigj Temali**

**Këngë për Shaban Mangjollin**  
Moj Drenicë moj lavdiplote  
Si vullkan kjo toka jote  
Sa herë ranë mbi ty shkrep'tima  
Mbushe malet plot me trima  
Moj Drenicë krahu i shqiponjës  
Nam e nder i le Kosovës  
Nam e nder i le Shqipnisë  
Djep i trimave të lirisë  
Sot këtë kangë që e kam marrë  
Ja kushtoj një trimi të rrallë  
Ja kushtoj birit të Drenicës  
Lindë e rritë n' fshat të Mikushnicës  
Aty u rrit biri i k'tij trolli  
Trimi i rrallë Shaban Mangjoll  
Shatat si lisi e trim si zana  
Djalë kreshnik e kish rritë nana  
Qysh prej kohëve familja e ti'  
Shumë pat vujtun nën Turqi  
Gjysh pas gjyshi - babë e djalë  
Gjithë furtunave u banë ballë  
Në kohë të turkut një vëlla të ti'  
Ja pat marrë mbreti gjynli  
Ja pat marrë mbreti asqer  
Nuk ju kthye ma asnjëherë  
Pat vendosë Shabani i ri  
Mos me i shkue mbretit gjynli  
Mos me ba hyzmet për mbret  
Duel koçak për vatan të vet  
N' tirq galana e mitan veshë  
Hije i kish manzerka ngjeshë  
Zoti në ta kish l' shue hijeshi  
Mendje të mprehtë e trimëri

S' vonoi shumë iku Turqia  
Prapë me të zi u m' lu Shqipnia  
Ditë të zeza për Shqipëri  
Mbi të l' shuen shumë krajli  
Plasën Luftat Ballkanike  
Njani shkojke tjetri vike  
Erdh Bugari e Austria  
E robnueme prapë Shqipnia  
Ish me she 'j familja e tij  
Për respekt e për trimni  
Po anmiqtë halle u vnojnë  
Me familje i internojnë  
Ja rrethojnë kullën e ti'  
Po Shabanin s' e gjajnë aty  
Muerën meshkuj, gra e thmi  
N' internim në Hungari  
N' Hungari në internim  
Për disa nuk pati kthim  
A kanë vdekë a i kanë vra  
Ma për ta nuk dihet gja  
Kobi i luftës vuejtje i solli  
Po s' u thye Shaban Mangjoll  
Me i dalë zot vendit e votrës  
Kishte shokë trimat e kohës  
Bukur shpesh në kullë të tina  
Pat qëndru Hasan Prishtina  
Se Hasanin e kish të gjakut  
E kish të fisit - burrë konakut  
Me ba luftën për lirinë  
Kishte shok Ahmet Delinë  
Trimave fjala u kish hije  
Lec Gradicën pat mik shpije  
Sadik Ramën e Gjurgjevikut  
E pat shok e pika e mikut  
Me pushkë në dorë ai kurrë s' u ndal  
Fshat me fshat e mal më mal  
Tuj rrug' tue si komitë  
Në Tërnafc pat ra në pritë  
Xhanaria kur e zunë  
E burgosen e internuen  
Dy vjet bani n' Austri  
Ikë nga burgu e kthehet në sh'pi  
Dy muej kambë nga Austria  
Vjen në Kosovë k'thehet te shpija  
Biri trim i Mikushnicës  
Ju bashkue Azem Galicës  
Në çetë të Azemit kurrë s' u nda  
Krah i djathtë ju ba si vëlla  
Me pushkë në dorë katërdhetë vjet  
Nuk e theu asnjë pushtet  
S' e ndalë lufta as rrufeja  
Tri plagë të randa i muer n' beteja  
Me pushkë në dorë katërdhetë vjet  
Për lirinë e popullit të vet  
Shumë e dhimbshme jeta e tij  
Po me nder dhe krenari  
Kur n' Kosovë erdh Partizani  
Me pushkë në dorë prapë Shabani  
Kurrë s' e lëshoi çarkun e pushkës  
Iu bashkue Shaban Polluzhës  
Shkau si gjarpni lëkurën ndërron  
Po adetin s' e harron  
Kishin plan çetnikët e zi  
Mbi Kosovë me l' shue ordi  
Kështu lanë nam trimat shqiptarë  
Tmerr për shkie e për tradhëtarë  
**Hamdi Kurti**

**REDAKSIA**  
Kryeredaktor: Luigj Shyti  
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,  
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:  
**MIRASH NDREZAJ**  
Dashmirës i Shoqatës Atdhetare  
Dukagjini, Shkodër

